

# Banka Botërore - Shqipëria

## Një vështrim i programit të partneritetit

### QERSHOR 2013



**BANKA BOTËRORE**



**BANKA BOTËRORE**

**Zyra e Bankës Botërore në Tiranë**

Rr. “Ibrahim Rugova”, Nr. 34,

Tiranë, Shqipëri

[www.worldbank.org.al](http://www.worldbank.org.al)

---

**Design & Layout**

Henrik Lezi

# Përmbajtja

Zhvillimet e fundit ekonomike dhe sektoriale.....	4
Programi i Bankës Botërore në Shqipëri.....	16

## PROJEKTET IBRD 18

Projekti për ofrimin e shërbimeve sociale në Shqipëri.....	19
Projekti i modernizimit të asistencës sociale në Shqipëri.....	22
Projekti i cilësisë dhe barazisë në arsim.....	23
Projekti i fuqizimit të rinjve nëpërmjet zhvillimit të komuniteteve .....	26
Programi i menaxhimit të integruar të zonës bregdetare dhe pastrimit.....	28
Projekti i menaxhimit të përmirësuar të burimeve natyrore në Shqipëri.....	31
Projekti për uljen e rrezikut të katastrofave natyrore.....	32
Projekti për administrimin dhe menaxhimin e tokës.....	34
Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale .....	37
Komuniteti energjetik i Evropës Juglindore	
APL5 – Shqipëri – Projekti për sigurinë e digave.....	40
Garancia e riskut të pjesshëm për privatizimin e operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë në Shqipëri.....	43
Liberalizimi i tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik.....	45

## PROJEKTET IFC 46

Projekti i eficiencës së energjisë për banesat.....	47
Hidrocentralet e vogla në Shqipëri dhe energjia e rinovueshme.....	48
Shqipëria: Programi i Evropës Juglindore për transparencën dhe thjeshtëzimin e taksave...50	
Shqipëria: Zgjidhja e borxhit.....	51
Shqipëria: Projekti i ifc-së në Ballkanin Perëndimor për logjistikën e tregtisë.....	52
Shqipëria: Enso Hydro Energji.....	54
Shqipëria: Bankers Petroleum.....	55

## PROJEKTET MIGA 56

Shqipëria: Energji Ashta sh.p.k.....	57
Shqipëria: Mbulimi i detyrueshëm i rezervave nga Banka Qendrore të Grupit Procredit.....	58
Shqipëria: Giorgi Alfo sh.p.k.....	60

# ZHVILLIMET E FUNDIT EKONOMIKE DHE SEKTORIALE


**QË** prej krizës globale financiare të viteve 2008-2009, rritja ekonomike në Shqipëri ka mbetur e tkurrur. Pas një dekade para-krizës me një normë mesatare rritjeje prej 6%, rritja ra në 3.3% në vitin 2009. Kriza çoi në uljen e dërgesave dhe eksporteve, që në këmbim kontribuoi në rritje dhe të ardhura fiskale më të ulëta. PBB-ja u rrit me 3.5% në vitin 2010 dhe 3% në 2011-ën, mbështetur kryesisht nga shërbimet dhe industria. Rritja ekonomike e Shqipërisë për vitin 2012 është dobësuar kryesisht për shkak të përkeqësimit të mjedisit të jashtëm. Të dhënat e PBB-së për tremujorin e tretë të 2012-ës treguan një ngritje në aktivitetin ekonomik, ku norma reale e rritjes arriti 2.7% (vit pas viti) nga 2.1% në tremujorin e dytë. Bujqësia arriti një rritje prej 5.6%, duke nxitur rritjen e përgjithshme me 1%. Shërbime të tjera (që përfshijnë arsimin privat), janë rritur gjithashtu me një normë prej 9%, duke kontribuar kështu me 2.3% në rritjen totale.

Shërbimet e komunikimit kanë pare norma rritjeje jashtëzakonisht të larta prej 21%. Megjithatë, rritja e tregtisë dhe hotelarisë u ngadalësua në mënyrë të konsiderueshme në 0.6% (vit pas viti) në periudhë më të aktive të vitit. Industria përjetoi rritje të fuqishme prej 11% (vit pas viti). Industria nxjerrëse u rrit me 21% (vit pas viti), pjesërisht si rezultat i rritjes së prodhimit të energjisë elektrike, që u bë e domosdoshme për shkak të kostos së lartë të importimit të saj, por që e çoi nivelin e ujit në digat e hidrocentraleve në një minimum kritik. Megjithatë, sektori i ndërtimit vijoi me tkurrjen dyshifrore. Të dhënat e fundit të mjedisit të biznesit konfirmuan një tremujor të fundit të vështirë për vitin 2012. Të gjithë sektorët shënuan norma negative rritjeje krahasuar me të njëjtën periudhë të një vit më parë. Rënia e sektorit të ndërtimit vazhdon pa asnjë shenjë përmirësimi. Gjendja e industrisë u përkeqësua në tremujorin e fundit dhe pritet të qendrojë negative deri në fillim të vitit 2013. Edhe mjedisi i shërbimeve u përkeqësua dukshëm në gjysmën e dytë të vitit

2012, megjithëse pritet të stabilizohet në vitin 2013.

**Disbalancat e jashtme po përmirësohen, por sërish mbeten të larta.** Pasi arriti 15% të PBB-së në vitin 2009, Deficiti i Llogarive Rrjedhëse (CAD) ra nën 12% të PBB-së në 2010 dhe 2011. CAD u ngushtua gjatë vitit 2012 në 15% (vit pas viti). Dobësimi i kërkesës së brendshme çoi në përmirësimin e deficitit tregtar me 9%. Kjo ishte kryesisht rezultat i tkurrjes së importeve për materialet e ndërtimit dhe makineri, që tregon kërkesë të brendshme të dobësuar. Sektori i minierave ka qenë një tjetër sektor që ka ndihmuar në zvogëlimin e deficitit tregtar duke shënuar eksporte të fuqishme për të tretin vit radhazi. Zgjerimi i këtij sektori që prej vitit 2009 duket i qëndrueshëm, gjë që tregon njëburim të mundshëm për rritjen ekonomike dhe të ardhurat nga taksat, të cilat ja vlen të vëzhgohen. Dërgesat dhe transfertat e tjera private mbetën pothuajse të pandryshuara, pavarësisht vështirësive në Greqi dhe Itali, ku punojnë pjesa më e madhe e shqiptarëve. Investimet e huaja direkte (FDI) ishin 21% më të larta se në vitin paraardhës duke filluar nga shtatori 2012. FDI-të janë të përqendruara tek ndërmjetësimi financiar, shërbimet dhe industria.

**RRITJA REALE E PBB-SË (% VIT – MBI – VIT)**




Burimi: vlerësim i INSTAT, 2011

**Inflacioni ka mbetur kryesisht brenda objektivit të Bankës Qendrore, prej 2-4%.** Pas një rënijeje të mprehtë që arriti 0.6% në shkurt të vitit 2012, inflacioni u ringrit gjatë

gjysmës së dytë të vitit, duke iu afruar objektivit të Bankës Qendrore prej 3%. Çmimet e ushqimeve kanë qenë shkaku kryesor i kësaj paqendrueshmërie. Inflacioni bazë (që nuk vjen nga qeratë apo ushqimet) mbetet në pothuajse 1%, duke reflektuar kështu dobësimin e prodhimit. Leku u luhet ndërmjet 137 dhe 140 kundrejt euros gjatë vitit 2012, duke e mbyllur vitin në mbi 139.

**INFLACIONI VJETOR (NE PËRQINDJE)**




Burimi: INSTAT.

## Performanca e Sektorit Fiskal

**E**sfektet negative të krizës globale të vitit 2009 e kanë shteruar hapësirën fiskale, duke e shtyrë borxhin publik mbi 60% të PBB-së në vitin 2012.

Stimuli fiskal që filloi në vitin 2008 përbëhej nga investimet publike (kryesisht rrugët) dhe rritjet në pagat publike dhe pensionet. Rritja rezultante në deficitet fiskale, kombinuar me 10 përqindëshin e zhvlerësimit të lekut, i solli nivelet e borxhit publik afër 60% të PBB-së, kufiri ligjor i vendosur në 2008-ën. Në vitin 2010 dhe 2011, me hapësirën e ngushtë fiskale dhe ngadalësimin e rritjes së të ardhurave, qeveria i shkurtoi shpenzimet në mes të vitit që të ruante objektivin e saj të deficitit dhe borxhin public brenda 60 përqindëshit. Kjo praktikë megjithatë çoi në grumbullimin e faturave të

papaguara dhe vonesave ndaj kontraktorëve privatë për punët publike dhe rimbursimin e taksës mbi vlerën e shtuar (TVSH). Për vitin 2012, megjithëse të ardhurat ishin sërish më të ulëta nga sa ishte parashikuar, qeveria nuk bëri rregullime të mesvitit në pritje të marrjes së të ardhurave nga privatizimi. Megjithatë, kanosja e ndërprerjeve të energjisë elektrike në pjesën e dytë të vitit 2012 dhe vonesat në përfundimin e transaksioneve të privatizimit, e kanë shtyrë nivelin e borxhit në 60.8% të PBB-së. Buxheti i Shqipërisë për vitin 2013 fokusohet tek deficitin fiskal i përgjithshëm qeveritar prej 3.4% dhe parashikon një rritje të mëtejshme të borxhit publik.



**Ulja e borxhit publik në periudhën afatmesme mbetet kritike për stabilitetin makroekonomik dhe rritjen ekonomike.** Si rezultat i nivelit të lartë dhe strukturës së borxhit, shpenzimet e interesave janë 2-3 herë më të mëdha sesa në vendet e tjera të Evropës Jugore dhe Lindore dhe zëvendësuan shpenzime të tjera më të rëndësishme. Aksione prioritare që po diskutohen me Bankën përfshijnë: (i) pastrimin e borxhit (200 milion \$ sipas vlerësimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar [FMN]) dhe kontrollimin më të mirë të angazhimeve të reja; (ii) forcimi i administrimit të taksave dhe eksplorimi i rii burimeve të të ardhurave; (iii) reformimi i rregullave dhe tarifave të tregut

energetik për ta bërë këtë sektor të mbështetet tek vetvetja si edhe (iv) reformimi i skemës së pensioneve për të frenuar deficitin fiskal të pensioneve. Përdorimi i privatizimit të të ardhurave, kurdo që mund të ndodhin, për shlyerjen e detyrimeve dhe reduktimin e borxhit do të ketë rëndësi thelbësore. Së fundi, qeveria ka përshpejtuar punën e saj në vendosjen e mekanizmave për të parandaluar rishfaqjen e detyrimeve në të ardhmen dhe është përkushtuar publikisht në shlyerjen e tyre si prioritet. Tryeza e Rrumbullakët e Politikave Fiskale organizuar nga FMN, BB dhe qeveria në shkurt të vitit 2013, riafirmoi rëndësinë e konsolidimit fiskal dhe nevojën për rregullim fiskal.


## Sektori Financiar

**S**ektori financiar ka mbetur relativisht i qëndrueshëm përballë krizës së vazhdueshme të eurozonës, por përballet me rreziqe që po përshkallëzohen për shkak të mjedisit të pafavorshëm të jashtëm dhe përkeqësimit e vazhdueshëm të cilësisë së huave bankare. Sektori bankar shqiptar, që është baraz me rreth 87% të PBB-së (2012, asete), përbëhet nga 16 banka, 5 prej të cilave zotërojnë së bashku tre të katërtat e aseteve të sistemit bankar. Katër prej këtyre bankave janë austriake, greke ose italiane. Që prej shtatorit të vitit 2012, norma e kapitalizimit të sektorit bankar ishte 15.9% dhe depozitat i tejkalonin nivelet e parakrizës (duke e marrë veten në mënyrë të vazhdueshme pas një rënieje të mprehtë në 2008-ën).

**Sistemi bankar parashikohet të ecë relativisht mirë pasi raporti ndaj totalit të huave është rritur katërfish që prej vitit 2007.** Banka e Shqipërisë është treguar proaktive në adoptimin e masave të kujdesshme për të ruajtur stabilitetin financiar, duke përfshirë këtu monitorimin nga afër të sektorit

financiar dhe transformimin e degëve të bankave në filiale. Një amendament i vitit 2011 ndaj Ligjit të Bankave e përforcoi kapacitetin e Bankës së Shqipërisë për t'u përballur me bankat në vështirësi duke u dhënë pushtetin për të themeluar një bankë që të shërbejë si urë. Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë gjithashtu krijuan Grupin e Veprimit të Sektorit Financiar në fillim të 2012-ës për të forcuar mbikëqyrjen makro të kujdesshme për sektorin financiar dhe për të mundësuar veprim të shpejtë në rast të një kërcënimi ndaj stabilitetit financiar. Megjithatë, pasiguria e vijueshme në Eurozonë ngre nevojën për vigjilencë të vazhdueshme dhe veprime të mëtejshme për të reduktuar dobësitë e mbetura të sektorit financiar, frenimin e valës në rritje të kredive të këqija (pjesa e së cilës është më e larta në rajon me mbi 22%) dhe nxitja e bankave për t'u rikthyer huadhënies sapo kërkesa e sektorit privat të rishfaqet. Grupi i Bankës ka ofruar asistencë teknike për reformat që po vijnë, duke përfshirë këtu një sërë masash për të reduktuar nivelin e kredive të këqija.

**KREDITË E KËQJIA (% E TOTALIT TË KREDIVE)**



## Papunësia dhe Varfëria

**P**erformanca e mirë ekonomike e Shqipërisë gjatë 10 viteve të fundit është shoqëruar me ndryshime po-

**zitive në punësim dhe reduktim të fuqishëm të niveleve të varfërisë.** Ndërmjet viteve 2002 dhe 2008, niveli i papunësisë ra nga afërsisht 17 përqind në 12.8 përqind, ndërsa niveli i varfërisë ra nga 25.4 përqind në 12.4 përqind, ekuivalente kjo me 200,000 njerëz të nxjerrë nga varfëria gjatë kësaj periudhe. Reduktimi i varfërisë ka qenë veçanërisht i dukshëm në zonat rurale, ku niveli i varfërisë ra nga 39.6 përqind në vitin 2002 në 14.6 përqind në 2008. Rritja ekonomike përbënte shkakun kryesor për reduktimin e niveleve të varfërisë gjatë periudhës 2002-2005 dhe kontribuoi me 3.7 nga 6.1 pike përqindje në reduktimin e nivelit të varfërisë gjatë periudhës 2005-2008. Pabarazia gjithashtu ka pësuar rënie në këtë periudhë, në një kohë kur individët në përqindjet më të ulëta të shpërndarjes, në krahasim me të tjerët, përjetuan rritje në nivelin e të ardhurave. Përqindja e popullsisë ekstremisht të varfër, e përkufizuar si njerëz me vështirësi për të siguruar nevojat bazike ushqyese, ra nga afërsisht 5 përqind në 2002 në 3.5 përqind në 2005 dhe në 1.2 përqind në 2008.

**Ka shqetësime se ndërsa rritja është ngadalësuar gjatë katër viteve të fundit, e njëjta gjë ka ndodhur me reduktimin e varfërisë në të gjithë vendin.** Ndërkohë që të dhëna sistematike dhe të përditësuara rreth varfërisë për Shqipërinë nuk janë të disponueshme, cënueshmëria familjare ka mundësi të jetë më e lartë se në të shkuarën. Dërgesat për shembull, janë tani më të ulëta sesa kanë qenë më herët gjatë kësaj dekade. Sondazhet e perceptimeve, si Sondazhi i Jetesës në Tranzicion i kryer në të gjitha vendet e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore në vitin 2010 nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Botërore, gjithashtu konfirmojnë shqetësimin. Rreth 60% e të anketuarve sugjeruan se kriza i ka prekur ata. Këto shqetësime mbështeten më tej nga të dhënat prej databazave rajonale dhe ato të vendeve fqinje (për shembull Serbia dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, që



kanë të dhëna më të vona krahasuar me Shqipërinë). Rezultatet e një Sondazhi të ri të Matjes së Standardeve të Jetesës, mbështetur nga disa donatorë dhe Banka Botërore, pritet të sigurojnë një matje të saktë të asaj që ka ndodhur me varfërinë gjatë viteve të fundit dhe të përmirësojnë përpjekjet për reduktimin e varfërisë.

**Progres ka patur në ndërtimin e një rrjeti të sigurimeve shoqërore** për të varfërit dhe masa të mëtejshme janë planifikuar për të përmirësuar barazinë, rendimentin, transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e burimeve për mbrojtjen sociale. Ndihma Ekonomike (NE), është programi më përfitues në para sa i përket asistencës sociale, duke siguruar një kompensim mujor për afërsisht 7.3 përqind të popullsisë (rreth 100,000 familje) në bazë të një vlerësimi paraprak të mjeteve të jetesës, për të parë nëse një individ përmbush kriteret për ndihmë financiare. Rreth ¼ e shpenzimeve të përgjithshme në asistencë sociale në Shqipëri (1.6 përqind të PBB), i dedikohet NE (0.3 përqind të PBB). Programi NE prodhon rezultate të respektueshme në terma të targetimit të saktësisë (mospërhapjes tek më të varfërit). 20 përqindëshi më i varfër, merr 56 përqind të të gjithë transfertave të NE-së, ndërkohë që në programet më të mira të asistencës sociale në rajonin ECA të paktën 80 përqind e përfitimeve kap 20 përqindëshin më të varfër të popullsisë. Qeveria në bashkëpunim me Bankën Botërore ka filluar reformën e programit për të përmirësuar lidhjen e tij me varfërinë nëpërmjet transferimit nga niveli qendror për tek bashkitë dhe nga përzgjedhja e përfituesve në nivel bashkiak.

**Banka ka mbështetur së fundmi mbrojtjen sociale në Shqipëri, përmes:** (i) Projektit për Ofrimin e Shërbimeve Sociale, projekt i cili po ndihmon në rritjen e aksesit të grupeve më vulnerabel të popullsisë në shërbime efektive të kujdesit shoqëror dhe përmirësimin e rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit të pensioneve në vend, (ii) Huasë për Politikën e Zhvillimit (DLP), që mbështet ndryshime në

kuadrin institucional dhe të politikave të ndryshme për të përmirësuar efektivitetin e rrjetit të sigurisë shoqërore; dhe (iii) Projektit për Modernizimin e Asistencës Sociale dhe reforma për aftësitë e kufizuara. Një grant i Fondit Japonez të Zhvillimit Social mbështet fuqizimin dhe programet e punësimit për të rinjtë në dy bashki kryesore.



## Sektori i shëndetësisë

**S**hërbimet shëndetësore janë përmirësuar, megjithatë mund të bëhet më shumë në mënyrë që të sigurohet akses universal edhe nga familjet e varfëra. Shqipëria shpenzon rreth 6 përqind të PBB-së në kujdes shëndetësor, çka është në të njëjtën linjë me mesataren për vendet me nivele të ardhurash të ngjashme. Kontributi i sektorit publik është relativisht i ulët, shumë më poshtë mesatares së Evropës Juglindore (EJL). Si rrjedhojë e shpenzimeve të ulëta në sektorin publik, shpenzimeve të paparashikuara në buxhet, sa i përket shërbimeve përbëjnë 60 përqind të financimit sektoral. Niveli i lartë i shpenzimeve të drejtpërdrejta të ekonomisë familjare tregon se sistemi ekzistues shëndetësor i ofron mbrojtje të kufizuar popullsisë ndaj katastrofave, sëmundjeve apo dëmtimeve dhe lejon vetëm një shpërndarje të kufizuar burimesh për mbrojtjen



e grupeve më të prekshme nga shoku shëndetësor. Barrierat ekonomike që hasin të varfërit për të patur akses në shërbimet cilësore, përkeqësohen nga mungesa e mbulimit të sigurimeve shëndetësore. Qeveria po punon për zhvillimin e një politike financuese shëndetësore që do të adresojë të gjitha këto probleme, bazuar edhe mbi një studim rajonal të Bankës mbi financimin shëndetësor.

**Banka ka mbështetur sektorin shëndetësor në Shqipëri** përmes projektit të porsambyllur për Modernizimin e Sistemit Shëndetësor, i cili asistoi qeverinë në përmirësimin e aksesit fizik dhe financiar në shërbimet shëndetësore të cilësisë së parë si edhe duke forcuar institucionet përkatëse. Huaja për Politikën Zhvillimore në sektorin social (DPL), mbështeti reformat për rritjen e efikasitetit dhe barazisë në shpenzimet për shëndetësinë dhe për të mbrojtur të varfërit nga problemet shëndetësore, duke përfshirë reformat në sigurimet shëndetësore, në një mjedis të qendrueshëm fiskal. Një projekt i ri për shëndetësinë është në fazat përgatitore.

## Arsimi

**R**ëndësia e arsimit dhe punës së kualifikuar si për individët dhe për zhvillimin ekonomik është e njohur gjerësisht në Shqipëri. Ndaj, në 2006 nisën reformat të mëdha dhe në një gamë të gjerë, të cilat përfshinin: (i) reformat e kurrikulave, duke përfshirë futjen e një kurrikule moderne të teknologjisë së informacionit në shkollat fillore dhe të mesme (ii) përmirësimi i trajnimit të mësuesve; (iii) shpërndarje e barabartë e burimeve në të gjithë rajonet; (iv) përmirësimi i kushteve të mësimin, me më pak klasa të mbipopulluara dhe më pak nevojë për ndërrim turnesh në shkollë; (v) rritja e rrogave mesatare të mësuesve; (vi) rinovimi i përmbajtjes dhe administrimit të provimit të maturës duke i lënë në dorë arsimit të mesëm arritjen e rezultateve objektive. Reformat ndërkohë po ecin përpara.



**Kanë nisur tashmë reformat të mëdha në arsimin e lartë.** Fokusi ka qenë tek adoptimi i standardeve të përputhshme me gjithë Europën, rritja e numrit të studentëve dhe prezantimi i cikleve të shkurtra dhe programeve në universitetet rajonale.

Fokusi është përqendruar gjithashtu tek rritja e efikasitetit dhe besueshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë, duke prezantuar një formulë të re financimi bazuar tek studenti, duke themeluar borde të jashtme këshilluese, vendosur një sistem akreditimi për universitetet dhe duke zhvilluar procedurat për renditjen e universiteteve.

**Banka mbështet një varg reformash gjithëpërfshirëse** në sektorin e arsimit në Shqipëri, përmes Projektit të Ek-selencës dhe Barazisë në Arsim që po financohet edhe nga Banka Europiane e Investimeve (EIB), Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEDB) si dhe një kontribut të qenësishëm nga qeveria.

## Bujqësia

**B**ujqësia është burim kryesor të ardhurash dhe punësimi në zonat rurale duke kontribuar me 21% të



**PPB-së dhe përbën 58% të punësimit në vend.** Sektori bujqësor i Shqipërisë është dominuar nga fermat private që prej kolapsit të shtetit komunist në vitin 1991, kur fshatarët fermerë shpërbënë fermat kolektive shtetërore. Aktualisht numri total i fermave private është 375,000, secila prej të cilave ka mesatarisht 1.1 hektarë kultura bujqësore të ndara në 4 parcela. Përveç kulturave bujqësore, 91 përqind e fermave merren me blegtori dhe 37 përqind e tyre me frutikulturë. 10 vitet e fundit, ka patur një tendencë në rënie në sipërfaqen totale të shfrytëzuar për kultura bujqësore, me një rënie drastike në atë për drithëra që kompensohet nga rritja e sipërfaqeve të mbjella me foragjere dhe në një masë më të kufizuar me perime.

**Sfidë mbetet transformimi i bujqësisë nga prodhimi si mjet jetese në një sektor më modern, i orientuar nga tregu dhe konkurrues,** duke nxitur ndërkohë mundësitë për të ardhura alternative për popullsinë rurale që po del nga sektori. Konkurrueshmëria mund të përmirësohet përmes rritjes së produktivitetit dhe rritjes së cilësisë së produkteve. Gjithashtu reformat në politikat bujqësore duhet të drejtohen brenda kontekstit të kërkesave të tanishme dhe të ardhshme të BE-së, duke përfshirë këtu harmonizimin

me legjislacionin dhe standardet e BE-së.

**Banka ka mbështetur bujqësinë në Shqipëri,** përmes investimeve në ujitje, ekspozimit ndaj teknologjive dhe praktikave të reja dhe përmes udhëheqjes së një program grantesh të vogla që është ndjekur më pas nga qeveria. Një Projekt i ri mbi Burimet Ujore dhe Ujitjen është aprovuar në nëntor të vitit 2012. Projekti do të: (i) forcojë kapacitetin e qeverisë për të manaxhuar burimet ujore si në nivel kombëtar ashtu edhe në basenin e lumenjve Drin-Buna dhe Seman si edhe (ii) të përmirësojë në mënyrë të qendrueshme performancën e sistemeve ujitëse në zonën e projektit.

## Mjedisi

**Q**everia e Shqipërisë po zbaton një gamë të gjerë politikash në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të burimeve natyrore. Shqipëria po ecën drejt përafrimit gradual të ligjeve të saj me legjislacionin mjedisor të BE-së. Sfida më e rëndësishme ka qenë zbatimi i kufizuar për shkak të kapaciteteve ende të dobëta të autoriteteve mjedisore në nivel qendror dhe rajonal dhe për shkak të mungesës së burimeve për monitorimin dhe sigurimin e përmbushjes së standardeve mjedisore.

**Banka po ndihmon në ruajtjen e kapitalit të çmuar natyror dhe mjedisor dhe në nxitjen e rritjes ekonomike lokale,** përmes projekteve të ndërmarra me mbështetjen e Global Environment Facility (GEF), dhe partnerëve të tjerë të zhvillimit. Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore synon të reduktojë rrezikun e erozionit duke përmirësuar menaxhimin e tokave moçalore, pyjeve, kullotave dhe baseneve. Projekti i Menaxhimit të Integruar të Zonës Bregdetare mbështet përmirësimin e infrastrukturës publike dhe shërbimet bashkiake të Bregdetit Jugor dhe reduktimin e rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore. Një projekt vijues po

përgatitet për të përmirësuar dhe promovuar vlerën e shërbimeve të ekosistemit, në partneritet me Agjencinë Suedeze të Zhvillimit Ndërkombëtar (SIDA). Përmes rigjenerimit të biomasës, komunitetet e varura nga hapësirat pyjore morën pjesë me sukses në Programin e Fondit të Bio Karbonit, duke reduktuar emetimin e gazit dhe duke fituar burime shtesë për nevojat lokale. Projekti i Menaxhimit të Integruar të Zonës Bregdetare mbështet përmirësimin e infrastrukturës publike dhe shërbimet bashkiake të Bregdetit Jugor dhe reduktimin e rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore nga



ndotja industriale. Projekti i porsa përfunduar i Menaxhimit të Integruar të Liqenit të Shkodrës ka ndihmuar në ruajtjen dhe zgjerimin e vlerës afatgjatë dhe shërbimeve mjedisore të Liqenit të Shkodrës dhe burimet e tij natyrore.

## Menaxhimi i Rrezikut të Fatkeqësive

**S**hqipëria është e ekspozuar ndaj një sërë rreziqesh e fatkeqësish si tërmetet, përmbytjet dhe thatësira. Ekonomia shqiptare është veçanërisht e ndjeshme ndaj kushteve atmosferike, duke patur parasysh rëndësinë e

bujqësisë, hidrocentraleve, peshkimit dhe turizmit. Banka Botërore mbështet Projektin e Zbutjes së Rrezikut të Fatkeqësive, i cili synon të forcojë kapacitetet institucionale, reduktojë vulnerabilitetin e Shqipërisë ndaj rreziqeve të shkaktuara prej njerëzve dhe të kufizojë humbjet njerëzore, ekonomike dhe financiare që vijnë si rrjedhojë e katastrofave. Shqipëria ishte anëtarja e dhe kontributorja e parë në Programin e Sigurimit nga Rreziqet dhe Fatkeqësitë. Paralelisht, burime grantesh nga Faciliteti Global për Reduktimin e Shkatërrimeve dhe Rimëkëmbjen kanë asistuar qeverinë në zhvillimin e një mediumi dhe opsione për lehtësimin e rrezikut të përmbytjeve për basenet lumore të Drinit dhe Bunës.

## Infrastruktura Urbane

**M**e një varg qytetesh bregdetare përgjatë Adriatikut, qytete historike dhe vende me trashëgimi kulturore mbrojtur nga Lista e Trashëgimive Botërore të UNESCO-s, Shqipëria ka një sërë vendesh të mrekullueshme dhe të veçanta për të vizituar. Vite të tëra financimi të pakët në infrastrukturën e qyteteve kanë sjellë prapambetje në nevojat e investimit në sistemin e ujësjellës-kanalizimeve, menaxhimit e mbeturinave, rehabilitimitin e rrugëve të brendshme të qyteteve dhe pajisjet urbane, elemente këto që mund të vendosin në rrezik perspektivat e turizmit si edhe standardet e jetesës për qytetarët shqiptarë.

**Grupi i Bankës Botërore po mbështet infrastrukturën urbane përmes disa projekteve të ndryshme.** Projekti i Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës (LAMP) po asiston në vëzhgimin dhe regjistrimin e rreth 400,000 pronave në zonat urbane, duke i pajisur banorët dhe bizneset me të dejta të sigurta pronësie. Katër qytete po mbështeten me investime bashkiake për të rritur dhe rehabilituar shërbimet e infrastrukturës urbane. Projekti i Investimit në Sektorin

e Ujësllësve (WSIP), i cili është në përgatitje e sipër, do të ndihmojë në përmirësimin e performancës së furnizimit me ujë dhe shërbimet për banorët lokalë dhe për turistët e ardhshëm. Disa workshop-e kombëtare dhe rajonale u mbajtën në Shqipëri në vitin 2012 nën programin e Institutit të Bankës Botërore për Qytetet e Qendrueshme. Ndërkohë Korporata Ndërkombëtare e Financave po punon me bashkinë e Tiranës (IFC- Projekti i Tiranës për mbetjet e ngurta), duke prezantuar pjesëmarrjen e sektorit privat në sistemin e manaxhimit të mbetjeve të ngurta për hedhjen dhe mbledhjen e mbetjeve.

## Transporti

**Z**gjerimi, përmirësimi, siguria dhe menaxhimi i rrjetit rrugor janë ndër prioritetet më të kryesore të qeverisë. Ai është përmirësuar me mbështetjen e partnerëve të tjerë të zhvillimit. Rishikimi i parë 5-vjeçar i Planit Kombëtar Shqiptar të Transportit tregon se gjendja aktuale është si më poshtë: 1/3 (31 përqind) e sektorit primar dhe gjysma (49 përqind) e sektorit dytësor të rrjetit kombëtar të rrugëve janë në kushte më pak se të mira, me 55 dhe 5 përqind, respektivisht, në gjendje të mirë dhe shumë të mirë.



Ky është një përmirësim i konsiderueshëm nga 2005 kur 67 përqind e rrjetit kombëtar rrugor ishte në një gjendje të keqe dhe shumë të keqe. Në kushte veçanërisht të këqija kanë qënë rrugët rajonale dhe lokale, ndaj qeveria është fokusuar në një program investimesh për përmirësimin e aksesit në komunitetet rurale. Në partneritet me disa institucione evropiane, Banka Botërore po e mbështet sektorin e transportit përmes Projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale.


**Çështja kyçe afatmesme është ruajtja e rrjetit dhe vijimi i forcimit të institucioneve në sektor.** Fokusi në sektorin e transportit kërkon një balancë të vështirë ndërmjet zgjerimit të rrjetit rrugor aty ku është ekonomikisht e leverdisshme, ndërkohë që duhet siguruar caktimi i burimeve për të ruajtur asetet. Këto çështje do të adresohen përmes grantit të Zhvillimit të Kapaciteteve të Evropës dhe Azisë Qendrore (ECAPDV), që u siguroi për të përgatitur një Projekt tëri për Ruajtjen dhe Sigurinë e Rrugëve që bazohet tek rezultatet. Ndër të tjera, financimi i këtij granti do të kontribuonte për të mbështetur qeverinë e Shqipërisë në priorizimin e nevojave të rehabilitimit/mirëmbajtjes së rrjetit rrugor kombëtar, duke zhvilluar një plan veprimi për të zbatuar reformat e sektorit dhe duke forcuar sigurinë e rrugëve.

## Energjia

**P**rioriteti kryesor është të vazhdojnë reformat në sektorin energjetik dhe të përmirësohet furnizimi me energji. Dekadën e fundit, gjatë viteve me reshje të pakëta, kombinimi i motit të thatë, tarifave të shijes me pakicë nën kosto prodhimi, humbjeve të larta në rrjet (teknike dhe joteknike), niveleve të ulëta të arkëtimeve dhe kërkesës në rritje nënkuptonte se KESH (Korporata Elektroenergje-



tike Shqiptare) mund ta vazhdonte furnizimin me energji vetëm me humbje, ose duhet të ndërmernte kufizime drastike. Në vitin 2008 qeveria filloi një reformë të rëndësishme në sektorin energjetik, duke përfshirë ndarjen e kompanisë shtetërore të energjisë elektrike (kompani të ndara të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes) dhe duke privatizuar shpërndarjen dhe aktivitetin e saj të furnizimit me pakicë. Gjatë periudhës 2009-2010 situata u përmirësua pasi besueshmëria e furnizimeve u rrit dhe nivelet e humbjes dhe kreditë e këqija në shpërndarje u reduktuan. Megjithatë, gjatë periudhës 2011-2012 një kombinim i thatësirës, dimrit të ashpër dhe dobësisë institucionale në sistem ulën edhe njëherë sigurinë e furnizimit duke sjellë nevojën e importit të energjisë, duke shtuar kështu problemet me shërbimet energjetike dhe buxhetin shtetëror.



**Vendit i duhet të diversifikojë burimet e furnizimit me energji dhe të reduktojë çënueshmërisëe sektorit nga ndryshimet klimaterike dhe në reshjet.** Hidroenergjia përbën mesatarisht 98% të prodhimit aktual të brendshëm të Shqipërisë. Ajo gjithashtu paraqet një mundësi për vendin që të bëhet një fuqi kyçe rajonale hidroenergjetike, duke i sjellë të ardhura të konsiderueshme gjatë viteve me




lagështirë. Ka patur disi progres në përmirësimin e furnizimit me energji elektrike përmes ndërtimit të disa hidrocentraleve të vogla, përmirësimit të rrjetit të transmissioinit (përfshirë këtu Projektin e Bankës Botërore të Transmissioinit në Komunitetin Energjetik të Evropës Juglindore), si edhe duke vijuar përpjekjet për të liberalizuar tregun energjetik. Vënia në punë e termocentralit të porsandërtuar, financuar nga BERZH, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore, u vonua për shkak të problemeve teknike me pajisjet në breg.

**Grupi i Bankës Botërore ka ofruar mbështetje të gjerë për sektorin energjetik gjatë viteve të fundit.** Aktualisht ajo po ndihmon për realizimin e potencialit të energjisë së rinovueshme dhe asaj hidrike dhe përmirësimin e shërbimeve energjetike. Banka po financon Projektin për Sigurinë e Digave, si edhe Garancinë e Pjesëshme ndaj Rreziqeve për kompaninë e shpërndarjes, së cilës iu hoq licenca së fundmi. IFC po e ndihmon qeverinë shqiptare me privatizimin e hidrocentraleve ekzistuese me madhësi mesatare, ndërkohë që programi këshillues për Energjinë e Rinovueshme në Ballkan ka ndihmuar qeverinë që të hartojë një ligj të ri për energjinë e rinovueshme për të mundësuar që sektori

privat të zhvillohet dhe të ndërtojë vepra ekonomike dhe të lehtësojë investime efikase energjetike rezidenciale. Koordinimi ndërmjet Bankës dhe IFC-së për këtë sektor ka qenë i fortë dhe do të vijojë të mbetet i tillë.

**Përpjekje të tjera të mëdha shitesë nevojiten për të rikthyer realizueshmërinë financiare të sektorit, rritur sigurinë e furnizimit, forcimin dhe përforcimin e rregullave të tregut dhe maksimizimin e manaxhimit të të ardhurave.**

Grupi i Bankës Botërore, në koordinim me institucione të tjera financiare ndërkombëtare, është angazhuar në një dialog me qeverinë për të përgatitur dhe mbështetur një plan gjithëpërfshirës reformash për rimëkëmbjen e këtij sektori.



## Zhvillimi i Sektorit Privat

**P**ërmirësimi i klimës së biznesit është një prioritet i rëndësishëm i qeverisë. Një nga fushat ku ka patur progres të dukshëm është korniza rregullatore dhe ligjore për biznesin, e cila është rishikuar dhe modernizuar vazhdimisht. Mes arritjeve janë reduktimi i konsiderueshëm në kohë (nga 36 në 5 ditë ndërmjet viteve 2008-2010) dhe kosto të regjistrimit të bizneseve, tregtisë ndërkufitare dhe

përmirësimeve të rregullore për marrjen e kredive dhe mbrojtjen e aksionerëve (indeksi i përhapjes u rrit nga 0 në 2008 në 8 në vitin 2010 dhe indeksi i mbrojtjes së investitorëve u rrit nga 2.7 në vitin 2008 në 7.3 në vitin 2012). Qeveria ka ndërmarrë gjithashtu disa reforma gjithëpërfshirëse për inspektimin. Që prej vitit 2011, qeveria ka përsheptuar përpjekjet për të forcuar të drejtat e pronësisë, megjithëse mbeten mangësi në disa prej fushave kyçe që lidhen me këtë sektor, si për shembull lejet e ndërtimit. Megjithatë, progresi kohët e fundit ka qënë i ndryshëm. Përpjekje më të guximshme nevojiten për të rritur konkurrueshmërinë e vendit, veçanërisht në lidhje me fqinjët, për të përmirësuar si renditjen tek Konkurrueshmëria Globale (89) ashtu dhe në renditjen e “Të bësh biznes” (85).

**Banka Botërore ka mbështetur zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri** nëpërmjet projektit të sapo mbyllur për Reformën në Mjedisin e Biznesit dhe Forcimin Institucional, regjistrimin e së drejtës së pronës me projektin e LAMP-it dhe asistencë teknike për reformat e të bërit biznes. Projekti ka kontribuar në përmirësimin e kuadrit ligjor për vlerësimin e impaktit rregullator dhe regjimin e inspektimit.



**Aktivitetet e IFC-së po zgjerohen në Shqipëri.** Prioritetet përfshijnë përgjigjen ndaj krizave, ndryshimet klimaterike dhe sektorët realë. IFC-ja gjithashtu po i fokuson shërbimet e saj të investimit në Shqipëri në rritjen e aksesit tek financat duke mbështetur zhvillimin e institucioneve financiare, veçanërisht ato që përqendrohen tek sipërmarrjet e vogla dhe të mesme. Përgjatë të gjithë sektorëve, IFC-ja prioritetizon investimet në rajonet më pak të zhvilluara të Shqipërisë dhe në projekte që kontribuojnë në diversifikimin më të madh ekonomik dhe integrimin rajonal. Që prej fundit të 2012, portofoli në Shqipëri ishte 197 milion \$. Investimet më të fundit të IFC-së në Shqipëri përfshijnë 6 milionë Euro për 20% të aksioneve në Enso Hydro Energji për ta ndihmuar atë të ndërtojë një seri projektesh të vogla hidroenergjetike, si edhe hua dhe investime kapitali në Bankers Petroleum dhe Antea Cement.

**IFC gjithashtu po mobilizon fondet veçanërisht për pjesëmarrjen private në infrastrukturë përmes shërbimeve të saj këshilluese.** IFC ka përdorur shërbimin këshillimor të Transaksioneve të Parteritetit Publik-Privat për të lehtësuar financimin e transaksioneve të partneritetit publik-privat për privatizimin e hidroenergjisë, manaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe operimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. IFC ka siguruar gjithashtu mbështetje këshilluese për të përmirësuar më tej klimën e investimeve në linjë me aspiratat e vendit për anëtarësim në BE. Programi IFC-së për klimën e investimeve në Shqipëri përfshin thjeshtëzimin e taksave, logjistikën e tregtisë dhe projekte për zgjidhjen e borxhit. Banka dhe IFC-ja kanë punuar drejt një qasjeje të integruar ndaj reformave në klimën e biznesit në aktivitete që promovojnë efikasitetin e energjisë, energjinë e rinovueshme dhe indikatorë kyç të “Të bësh biznes”. Projektet e IFC-së për efikasitetin energjetik dhe energjinë e rinovueshme po kontribuojnë në arritjen e këtij qëllimi.

IFC-ja po ofron edhe këshilla mbi qeverisjen e korporatave në Shqipëri.

## Qeverisja dhe manaxhimi i sektorit publik

**P**erformanca e sektorit publik është vendimtare për aspiratat e vendit drejt anëtarësimit në BE. Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në përmirësimin e kuadrit buxhetor dhe sistemit të menaxhimit financiar. Banka Botërore ka vijuar mbështetjen e saj në përmirësimin e administratës publike, manaxhimin e financave publike dhe qeverisjen me fokus në manaxhimin e financave publike.

**Banka në partneritet me shumë donatorë të tjerë po mbështet një sërë programesh.** Projekti i Sistemit të Integruar të Planifikimit (IPS) synon të sigurojë që politikat thelbësore dhe proceset financiare të Qeverisë Shqiptare të funksionojnë në mënyrë koherente, efçiente dhe të integruar. Programi REPARIS, gjithashtu i financuar prej një fondi shumëdonatorësh sigurimi, po ndërmerret me qëllim që të sjellë raportimin financiar në të njëjtën linjë me kërkesat e Bashkimit Europian. Mbështetje e mëtejshme ndaj çështjeve dhe sektorëve të vecantë nëpërmjet Programit të Partneritetit të Qeverisjes (GPF), përfshirë pilotimin e suksesshëm – të parin në Evropën dhe Azinë Qendrore – të sistemit të prokurimit elektronik në një nga projektet e Bankës. Qeveria e Shqipërisë mbajti Forumin Rajonal të Prokurimit në Tiranë në Maj 2012, i cili u fokusua në prokurimin e elektronik. Progres u arrit gjatë vitit të shkuar edhe me pjesëmarrjen e Shqipërisë në Iniciativën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI).



# PROGRAMI I BANKËS BOTËRORE NË SHQIPËRI

**Q**ë nga anëtarësimi i Shqipërisë në Bankën Botërore në vitin 1992, Banka ka financuar 72 projekte në sektorë të ndryshëm duke arritur një total prej 1.2 miliard \$ nga Shoqata Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA) dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD). Duke shtuar këtu financimet e GEF dhe burime të tjera fondesh besimi manaxhuar nga Banka Botërore, financimi total i Bankës Botërore për Shqipërinë llogaritet të arrijë 1.4 miliard \$.

**Strategjia e re e Partneritetit me Shqipërinë të Grupit Bankar për periudhën 2011-2014** mbështet Strategjinë Kombëtare të Qeverisë për Zhvillim dhe Integrim duke u fokusuar në tre objektiva strategjikë: (i) përshejtimin e ringjalljes ekonomike drejt rritjes së lartë në Europën e paskrizës; (ii) Ruajtjen dhe zgjerimin e përfitimeve sociale në Shqipëri; dhe (iii) reduktimin e ndikueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike. Strategjia e re e Partneritetit me Vendin (CPS) gjithashtu mbështet përmirësimet në sektorin e qeverisjes në Shqipëri dhe axhendën e integritimit në BE. Ajo fokusohet në përshejtimin e zbatimit të një programi të gjerë në vazhdim e sipërnë Shqipëri duke ofruar në të njëjtën kohë huadhënie të reja të IBRD-së në sektorët strategjikë, duke rritur financimet e IFC-s për sektorin privat në një nivel prej 120-150 milionë \$, duke forcuar partneritetin me donatorë dhe institucione të tjera ndërkombëtare financiare, dhe duke zgjeruar programin e saj të dijeve përmes aktiviteteve kombëtare dhe rajonale. Si pjesë e iniciativës së saj për të ndihmuar disa vende në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore në zbatimin e ndikimeve të krizës së eurozonës, BNRZH ka rritur zarin financues që është


në dispozicion të Shqipërisë sipas CPS-në, që fillimisht ishte vendosur në rreth 300 milion \$ dhe tashmë është 575 milion \$, kryesisht për të forcuar qendrushmërinë financiare, manaxhimin makroekonomik dhe rritjen. Raporti i Progresit është përgatitur duke rikonfirmuar prioritetet e CPS-së, më një fokus më të madh tek mbështetja e rritjes, konkurrueshmërisë dhe zhvillimit të sektorit energjetik.

## Programi Analitik dhe Këshillimor

**R**aporti i titulluar Axbenda e Re e Rritjes, i njohur gjithashtu si Memorandumi Ekonomik i Vendit, u prezantua në vitin 2010. Me mbështetjen e GPF-së, Banka ka nxjerrë disa raporte në vitin 2011 për çështjet e qeverisjes: profilin e përgjithshëm të qeverisjes, të drejtat e pronësisë, sektori i furnizimit me ujë dhe arsimit. Raporte të tjera përfshijnë: Vlerësimi i Manaxhimit të Borxhit dhe Llogaridhënia Financiare dhe Shpenzimet Publike (PEFA). Tri çështje të Raportit Ekonomik Rajonal (RER) për Evropën Juglindore, përfshirë Shqipërinë, u prezantuan në nëntor të vitit 2011, qershor 2012 dhe dhjetor 2012. Një raport i titulluar Rishikim i Financave dhe Shpenzimeve Publike është planifikuar për vitin 2013. Puna analitike dhe asistencë teknike është kryer edhe përmes programeve rajonale, në sektorin financiar, menaxhimin financiar publik, kontabilitetin e korporatave, monitorimin e varfërisë, reforma e pensioneve, sektori energjetik, ujësjellësit, zbatimin e Konventës së Aarhusit dhe mjedisit.

**Portofoli aktual përbëhet nga 9 projekte me një total prej 258.6 milion \$ si kredi të Shoqatës së Zhvillimit dhe**

hua të Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim dhe rreth 19 milion \$ në grante. Vitet e fundit ky portofol është konsoliduar në mënyrë të konsiderueshme, nga 18 projekte në fund të vitit fiskal (VF)09 në 9 projekte në VF13. Performanca e matur nga disbursimi ka treguar përmirësime të qendrueshme gjatë dy viteve të fundit, 22 dhe 24% në VF11 dhe VF12 respektivisht. Ky progres ishte rezultat i një numër hapash të ndërmarra në bashkëpunim me qeverinë për të thjeshtuar portofolin, ristrukturuar projektet problematike dhe përmes rishikimesh të rregullta të performancës së portofolit.



*Financimi shtesë për Sigurinë e Digave* (21.6 milionë US\$) dhe *Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale* (50 milionë US\$)—projekti i parë i financimit bazuar në rezultate në Shqipëri— u miratuan në VF12. Në VF13 u miratua *Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes* (40 milionë US\$), ndërsa *Projekti i Investimit në Sektorin e Ujit* (50 milionë US\$) është në fazën e vlerësimit. Po përgatitet gjithashtu një projekt në sektorin e energjisë.

**Një portofol i gjerë i Granteve prej 19 milionë \$ është një kontribut i vlefshëm në forcimin e dialogut dhe rezultateve në fushat që janë prioritet i CPS-it.** Ai reflekton gjithashtu koordinimin dhe partneritetin e fuqishëm me donatorët. Përveç një sërë fondesh besimi të lidhura drejtpërsëdrejti me projektet, programi forcohet edhe me fonde besimi të veçanta, siç është një fond besimi prej 1.95 milionë US\$ nën programin REPARIS për përmirësimin e raportimit financiar, Fondi Japonez për Zhvillimin Social (JSDF) prej 1.1 milion US\$ për fuqizimin e të rinjve; një fond besimi Suedez për Menaxhimin e Burimeve Natyrore 2.8 milionë US\$. Fondi i dytë i besimit më mbështetjen e shumë donatorëve për Sistemin e Integruar të Planifikimit të Integruar (IPS) aktualisht rreth 4 milionë US\$, që do të bëhet aktiv së shpejti.

**Banka Botërore u ka dhënë grante organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri** në kuadrin e Fondit të Shoqërisë Civile, në shumën e 436,000 \$. Në periudhën 2011-2012 një panair i ideve krijuese mbi qeverisjen e mirë promovoi ide novatore të shoqërisë civile për të përmirësuar qeverisjen dhe llogaridhënien. **Qendra e Informimit të Bankës Botërore**, vendosur në Universitetin e Tiranës, lehtëson aksesin e studentëve, akademikëve dhe shoqërisë civile ndaj informacionit për çështjet e zhvillimit me raportet dhe aktivitetet globale të Bankës Botërore, në rajon dhe në Shqipëri. Ajo shërben si një qendër e rëndësishme informimi dhe dijeje duke ofruar gjithashtu akses online falas për vizitorët. Zyra e Bankës Botërore në Shqipëri ka promovuar gjithashtu iniciativën Open Data Albania duke ndërmarrë disa udhëtime në universitete të ndryshme të vendit.

**PROJEKTET IBRD**

# Projekti per ofrimin e shërbimeve sociale në Shqipëri

## DATAT KRYESORE:

Data e nënshkrimit: 3 korrik 2001  
Data e fillimit: 28 janar 2002  
Data e mbylljes: 30 shtator 2010  
Data e rishikuar e mbylljes: 30 mars 2012

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Kredi e IDA-s	15.0
Qeveria e Shqipërisë	2.5
Departamenti Britanik për Ndërhyrjet Ndërkombëtare (DFID)	2.5
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH)	5.0
<b>Kostoja Totale e Projektit</b>	<b>20.00</b>

## DISBURSIMI NGA BANKA BOTËRORE NË MILION \$ \*:

	Totali	Disbursuar	Pa Disbursuar
Kredi e IDA-s	15.00	12.70	2.30

\* deri në mars 2013.

Shënim: Disbursimet mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

**K**ohëzoni i pamjaftueshëm i shoqërisë shqiptare, mungesa e kapitalit social dhe përjashtimi social i grupeve të cënueshme karakterizojnë dekadën e fundit në Shqipëri. Popullata e cënueshme është përballur me fenomene të tilla si: izolimi, perceptimi negativ i publikut, informacioni i pamjaftueshëm mbi të drejtat e tyre etj. Kjo, së bashku me mungesën e aksesit tek shërbimet dhe me mbulimin e dobët (sidomos në zonat rurale) ka kontribuar në përkeqësimin e problematikës. Ka patur një rrezik në rritje lidhur me nivelet e larta të migrimit, të cilat nxjerrin problematika të tilla si: numri i madh i beqarëve në moshë të shkuar në zonat rurale, familje, me kryefamiljare grua, një numër në rritje fëmijësh të braktisur etj. Bazuar në një program të qeverisë shqiptare, Banka Botërore po jep mbështetje për një formulim më të mirë të politikave dhe për të zbatuar kuadrin ligjor për të adresuar financimin,

cilësinë dhe shpërndarjen e shërbimeve sociale. Duke patur parasysh dobësitë që paraqet sistemi i pensioneve dhe prioritetin e qeverisë për reformimin e administratës së sistemit të pensioneve, një financim shtesë u dha nga Banka (në maj 2009), i cili synonte përmirësimin e efektivitetit dhe eficiencës të sistemit të pensioneve në vend.

Objektivat e këtij Projekti, duke përfshirë edhe financimin shtesë, janë përmirësimi i standardeve të jetesës të grupeve të varfëra dhe cënueshme të popullsisë në Shqipëri duke rritur aksesin e tyre në shërbime shoqërore të mire-adresuara dhe efikase; asistimin e qeverisë në zhvillimin e politikave efikase të kujdesit shoqëror dhe përmirësimin e kapacitetit të saj për shpërndarje dhe monitorim të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Gjithashtu, projekti synon përmirësimin e efikasitetit dhe eficiencës së sistemit të pensioneve në Shqipëri.



### PARTNERËT KYÇ

Ekipi i Bankës ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta duke qenë se ky e fundit është një institucion kryesor në reformimin e politikave sociale dhe menaxhimin e zbatimit të projekteve që lidhen me këtë fushë, Institutin e Sigurimeve Shoqërore i cili ka për detyrë zbatimin e aktiviteteve nën financimin shtesë të projektit dhe me Ministrinë e Financave e cila është përgjegjëse për reformën e përgjithshme të politikave të sistemit të pensioneve.

### PARTNERËT KYÇ NË ZHVILLIMIN E PROJEKTIT

UNICEF dhe Bashkimi Evropian.

## REZULTATET E ARRITURA:

- I gjithë kuadri ligjor është plotësuar dhe aktualisht po zbatohet.
- Tre pyetësorë për Matjen e Standardeve të Jetesës dhe një pyetësor për Buxhetin e Familjeve (ndërmarrë nga INSTAT-i) janë mbështetur dhe përfunduar me sukses.
- Rezultate pozitive janë arritur në ndërtimin e kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal. Instituti Shtetëror i Shërbimeve Sociale është transformuar në një Inspektoriat për monitorimin, manaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale.
- 44 qendra ditore janë ngritur me ndihmën e këtij projekti.
- Është siguruar mbështetja e Strategjisë së Qeverisë për decentralizimin/liberalizimin dhe transformimin e qendrave rezidenciale të kujdesit.
- Ndërtesa e Arkivës është rehabilituar me sukses.
- Tetë zyra rajonale të Institutit kanë përfunduar rehabilitimin fizik të ndërtesave të tyre, nga 12 zyra që janë në total.
- Të gjitha pajisjet e kërkuara për Arkivën SII janë blerë dhe aktualisht po instalohen. Pritet që deri në mars të vitit 2013, data e mbylljes së projektit, Arkiva SII të jetë tërësisht funksionale.





# Projekti i modernizimit të asistencës sociale në Shqipëri

## DATAT KRYESORE

Aprovuar: 7 mars 2012

Hyrja në fuqi: Ende nuk ka hyrë në fuqi

## FINANCIMI NË MILION EURO:

Financuesit	Financimi
Hua e BNRZH	38.00
Qeveria e Shqipërisë	147.82
<b>Kostoja totale e projektit</b>	<b>185.82</b>

\* as of March 2013

**O**bjektivi i projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale në Shqipëri është të mbështesë vendin në zbatimin e reformave për të përmirësuar barazinë dhe efikasitetin e programeve të asistencës sociale. Projekti ka dy komponentë:

1. Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale. Objektiv i këtij komponenti është mbështetja e rezultateve nga përmirësimi në programet kryesore të asistencës sociale. Ky komponent do të mbështesë zbatimin e përmirësuar si të programit të Ndhmës Ekonomike (NE) ashtu edhe të përfitimeve nga asistenca për aftësitë e kufizuara në fushat kryesore të identifikuara në hartën e gjerë të reformave: (a) parametrat e programit (kriteret e përzgjedhjes dhe proceset e marrjes së ndihmës); (b) përfitimet e administratës (proceset e bizneseve, manaxhimi i informacionit, mekanizmat e pagesave dhe raportimi dhe monitorimi) si edhe (c) mbikëqyrja dhe kontrollet.
2. Asistencë teknike për të forcuar kapacitetet zbat-

uese të programeve të asistencës sociale. Objektivat e këtij komponenti janë të forcohet kapaciteti për përmirësimin e zbatimit në shpërndarjen e përfitimeve nga asistenca sociale. Ky komponent do të financojë aktivitete të përzgjedhura për asistencën teknike dhe investimet.

## PARTNERËT KRYESORË

Ekipi i Bankës po punon me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

## PARTNERËT KRYESORË TË ZHVILLIMIT

Bashkimi Evropian

## REZULTATET E ARRITURA

- Projekti sapo ka filluar zbatimin dhe po vijon me aktivitetet fillestare



# Projekti i cilësisë dhe barazisë në arsim

## DATAT KRYESORE:

Data e nënshkrimit: 1 qershor 2006

Data e fillimit: 4 tetor 2006

Data e mbylljes: 30 qershor 2013

Financimet nga të gjithë bashkëfinancuesit në milion \$:

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Kredi e IDA-s	15.0
Qeveria e Shqipërisë	30.0
Donatorë të tjerë (EIB)	15.0
Donatorë të tjerë (CEDB)	30.0
<b>Kostoja totale e Projektit</b>	<b>75.0</b>

## DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILION \$ \*:

	Totali	Disbursuar	Pa Disbursuar
Kredi e IDA-s	15.91	8.24	7.93

\* deri në mars 2013. Shënim: Shumat e paguara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të shkëmbimit në kohën e disbursimit.

**N**ë mënyrë që të ruajë rritjen ekonomike, të ulë pa-barazinë ndërmjet rajoneve dhe përmësh aspiratat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Shqipëria po forcon sektorin e arsimit që të prodhojë të diplomuar që të jenë efektivë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe që do të bëhen qytetarë active, për të kontribuar për forcimin e konkurrueshmërisë së Shqipërisë.

Pavarësisht përmirësimit të dukshëm në performancën arsimore siç është matur edhe prej PISA-s së fundit, rezultatet në arsim të Shqipërisë mbeten përgjithësisht të varfra, sidomos nëse krahasohen me nevojat e tregut të punës dhe arritjeve në vendet e tjera të rajonit. Numri mesatar i viteve të shkollimit të fëmijëve shqiptarë është dukshëm nën mesataren e BE-së, niveli i regjistrimit në arsimin

dytësor është gjithashtu i ulët, shkollat janë të tejmbushura dhe cilësia e tyre është shqetësuese. Në Sondazhin e vitit 2009 mbi Klimën e Investimit (ICS), 51% e firmave të mëdha, 41% e eksportuesve dhe 48% e firmave të huaja raportuan aftësitë si një prej pengesave kryesore. Mbi 35% e firmave që futën teknologji të reja kanë përmendur arsimimin e forcës punëtore si një prej pengesave kryesore. Projekti mbështet prioritetet strategjike të qeverisë për këtë sektor.

Objekivi i projektit është mbështetja e programit të qeverisë së Shqipërisë për të: (a) përmirësuar cilësinë e kushteve të mësuarit për studentët; (b) rritur regjistrimin e studentëve në arsimin e përgjithshëm të mesëm dhe (c) filluar reformën e arsimit të lartë.



## REZULTATET E ARRITURA

- Në periudhën 2006-2011, shifrat e pjesëmarrjes u rritën në të gjitha nivelet. Për më tepër progresi nga arsimit bazë në atë dytësor u rrit nga 80% në 91% gjatë kësaj periudhe.
- Regjistrimi bruto për arsimin e mesëm u rrit nga 53% në vitin 2006 në 76% në 2011-ën.
- Reformat në arsimin parauniversitar përfshijnë prezantimin e forcave të tregut dhe zgjedhjen e bazuar tek shkolla për botimin dhe blerjen e teksteve shkollore, një kurrikul për shkollat e mesme të përgjithshme që tashmë ofron më tepër opsione, prezantimi i skemave të zhvillimit profesional për mësuesit dhe zhvillimi i një vlerësimi të centralizuar të arritjeve dhe sistemin e pranimit në universitet. Pjesa më e madhe e këtyre reformave janë bazuar tashmë ligjërisht në ligjin e aprovuar nga Parlamenti për arsimin parauniversitar.
- Është ofruar trajnim në manaxhim dhe aftësi udhëheqëse në arsimim për të gjithë drejtorët e

### PARTNERËT KYÇ:

Ekipi i Bankës po bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe me mbështetjen indirekte të autoriteteve të bashkive.

### PARTNERËT KYÇ TË ZHVILLIMIT:

Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës

shkollave dhe mbi 90% e shkollave fillore dhe të mesme kanë borde funksionale. Për më tepër, rreth 12500 mësues kanë marrë trajnimin e duhur në kuadër të këtij projekti.

- Sipas një Sondazhi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, kënaqësia e mësuesve nga puna është rritur nga viti 2006 në 2012-ën.
- Të gjitha shkollat fillore raportojnë se po përdorin kurrikulën e re dhe librat e rinj.
- Është prezantuar një kurrikul informuese për teknologjinë; janë blerë kompjutera për mbi 2000 shkolla fillore dhe të mesme dhe aksesit në internet është gjerësisht i disponueshëm. Raporti kompjuter për student në shkollat e mesme të përgjithshme ka rënë nga 61 në 16 student për kompjuter.
- Përmirësime vihen re tek zgjerimi i hapësirave në shkollë, me përqindjen e shkollave bazë që ka shkuar nga 36 në 16 dhe për shkollat e mesme nga 15 në 8 (kjo i atribuohet pjesërisht ndërhyrjes së projektit).
- 250 laboratorë kimie dhe 250 biologjie janë vënë në dispozicion të shkollave fillore dhe 100 laboratorë kimie dhe 100 biologjie janë vënë në dispozicion të shkollave të mesme të përgjithshme.
- Reforma të rëndësishme po ndërmerren në arsimin e lartë që priten të rrisin efikasitetin dhe llogaridhënien e këtyre institucioneve.

# Projekti i fuqizimit të të rinjve nëpërmjet zhvillimit të komuniteteve

## DATAT KRYESORE:

Data e nënshkrimit: 6 nëntor 2009

Data e fillimit: 6 nëntor 2009

Data e mbylljes: 6 nëntor 2013

## FINANCIMET NGA TË GJITHË BASHKËFINANCUESIT NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Fondi Japonez i Zhvillimit Social	1.15

## PAGESAT E BANKËS BOTËRORE NË MILION \$ \*:

	Totali	Disbursuar	Pa disbursuar
Granti	1.15	0.56	0.59

\*Deri në mars 2013.

Shënim: Shumat e paguara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të shkëmbimit në kohën e disbursimit.

**O**bjektivi i këtij projekti është të rrisë aksesin e grave dhe të rinjve tek mundësitë për arsimim, punësim, pjesëmarrje qytetare dhe zhvillim të komunitetit nëpërmjet rritjes së aftësive të tyre të cilat mbështesin tranzicionin nga arsimi i mesëm si forcë punëtore; rritja e aksesit tek mundësitë e jetesës dhe punësim nëpërmjet granteve që mbështetin aktivitetet sipërmarrëse të të rinjve si dhe rritja e përfshirjes së të rinjve në punët qytetare nëpërmjet granteve për zhvillimin e komunitetit.

Projekti konsiston në komponentët e mëposhtëm:

**Komponenti A: Krijimi i Kapaciteteve për të Rinjtë:** Aktivitete për të mbështetur ndërtimin e kapaciteteve të OJF-ve të rinjve dhe të agjencive të qeverisjes vendore për zhvillimin dhe përcaktimin e politikave dhe programeve të

tye lidhur me asistimin e djemve dhe vajzave të reja për t'u pajisur me aftësi për jetën që do t'iu shërbejnë për të hyrë me sukses në tregun e punës.

**Komponenti B: Grante për të Rinjtë për Sigurimin e Jetesës:** Dhënia e granteve të vogla për të rinjtë dhe grupet e të rinjve për të financuar aktivitete të përzgjedhura të komunitetit për të nxitur vetëndihmesën dhe shpirtin e sipërmarrjes tek të rinjtë dhe të rejat.

**Komponenti C: Grante për Zhvillimin e Komunitetit:** Aktivitete për të ndërtuar kapacitetin e të rinjve në identifikimin e prioritetëve të zhvillimit të komunitetit dhe të lagjes dhe për të promovuar përfshirjen e të rinjve në udhëheqjen vendimarrëse të komunitetit dhe në sipërmarrje.

## REZULTATET E ARRITURA

- Projekti përmbylli 5 projekte të vogla komuniteti nga 20 në periferitë e Tiranës dhe Durrësit, që kanë krijuar ose rehabilituar mjedise sportive dhe çlodhjeje për rreth 6000 të rinj dhe komunitetin. Tetë projekte të tjera komuniteti po zbatohen dhe do të përfundojnë në mars-prill



### PARTNERËT KYÇ

Ekipi i Bankës po bashkëpunon ngushtë me Qendrën Kombëtare Shqiptare për Studimet Shoqërore (NACSS) dhe me mbështetjen indirekte të autoriteteve bashkiake të Tiranës dhe Durrësit.

### PARTNERËT KYÇ TË ZHVILLIMIT

Organizata joqeveritare rinore në nivel lokal.

2013.

- 121 të rinj janë trajnuar në aftësi bazë në “Si të nisësh një biznes të vogël” dhe 8 prej tyre u zgjodhën për një grant prej 2500 \$ dhe kanë filluar aktivitetin e bizneseve të tyre të vogla në janar 2013.
- 227 të rinj kanë marrë trajnim profesional, prej të cilëve 47 kanë filluar punë (19 femra dhe 28 meshkuj).
- Në shkurt të vitit 2013 një trajnim për aftësitë jetësore u krye me rreth 245 të rinj nga lagjet më të varfra të Tiranës dhe Durrësit.
- Nga marsi i vitit 2011 deri në dhjetor 2012, rreth 187 të rinj morën shërbime trajnuese në qendra trajnimi profesionale dhe 40 të tjerë shërbime stazhi afër bizneseve lokale. Rreth 11% e të trajnuarve në kurse profesionale janë të rinj nga grupe minoritare si romë, persona me aftësi të kufizuara, viktima të trafikut njerëzor dhe ish përdorues droge.
- Kurse profesionale u ofruan në tema të tilla si: gjuhët e huaja (Anglisht dhe Gjermanisht); aftësi kompjuterike; animatorë socialë; guida turistike; instalime elektrike; riparim i pajisjeve elektrike/elektronike dhe rrobaqepësi, kuzhinier dhe specialist finance dhe kontabilist. Stazhe u ofruan edhe për punonjësit e industrisë së veshjeve dhe instalimet elektrike u siguruan për zbulimin dhe dritat e qytetit.

# Programi i manaxhimit të integruar të zonës bregdetare dhe pastrimit

## DATAT KRYESORE:

Data e nënshkrimit: 29 qershor 2005  
 Data e fillimit: 25 nëntor 2002  
 Ristrukturuar: 22 mars 2010  
 Data e mbylljes: 30 qershor 2014

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Kredi e IDA-s	17.50
Qervia e Shqipërisë	5.71
Donatorë të tjerë (Qeveria Holandeze)	3.11
Donatorë të tjerë (Qeveria Japoneze)	2.23
Donatorë të tjerë (Qeveria Austriake)	2.60
Donatorë të tjerë (KE)	1.80
Donatorë të tjerë (GEF)	0.95
<b>Kostoja totale e Projektit</b>	<b>38.56</b>

## DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILION \$ \*:

	Totali	Disbursuar	Pa disbursuar
Kredi e IDA-s	17.50	7.4	10.1

\*deri në mars 2013.

Shënim: Shumat e paguara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

Në vitin 2002, Shqipëria ndërmori një iniciativë për manaxhimin e integruar të zonës bregdetare për të mbrojtur këtë zonë për brezat e sotëm dhe të ardhshëm si dhe adoptoi zyrtarisht rekomandimet kryesore të Konventës së Barcelonës për Mbrojtjen e Detit të Mesdheut. Projekti për Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare dhe Pastrimit luajnë një rol katalitik për mobilizimin e asistencës së zhvillimit dhe përmirësimin e kushteve mjedisore dhe sanitare, të cilat janë thelbësore për zhvillimin afatgjatë të bregdetit dhe turizmin.

Objektivi i zhvillimit të projektit është të asistojë qeverinë shqiptare për të zhvilluar, mbi baza të qëndrueshme, turizmin në Bregdetin e Shqipërisë së Jugut duke përmirësuar infrastrukturën kryesore publike mjedisore dhe shërbimet lokale, rregulluar dhe ndaluar problematikën me ndotjen që vijnë nga një ish-fabrikë kimike në Porto Romano afër Durrësit, si dhe duke përmirësuar infrastrukturën komunitare dhe rritur burimet arkitekturore dhe kulturore. Projekti u ristrukturua në vitin 2010.







## REZULTATET E ARRITURA

- Janë aprovuar Plani Rregullator i Zhvillimit të Bregdetit të Jugut (SCDP) pas një dialogu me palët e interesuara në nivel qendror, rajonal dhe lokal.
- Pastrimi i pikës së nxehtë në Porto Romano u përfundua në vitin 2011 me më tepër se 45000 m<sup>3</sup> mbetjesh të rrezikshme që u mblohdën dhe u izoluan, duke mbrojtur kështu popullsinë e Porto Romanos nga rreziqet për shëndetin.
- Faza e Parë e Programit të Ruajtjes dhe Zhvillimit të Fshatrave Bregdetare u përmbyll

### PARTNERËT KYÇ

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, e cila është përgjegjëse për koordinim e përgjithshëm të projektit dhe manaxhim, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që është përgjegjëse për pastrimin e zonave problematike afër Durrësit, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe menaxhimin e rretheve dhe bashkive bregdetare, këshillat e fshatrave në komunitetet bregdetare si edhe OJF lokale.

### PARTNERËT KYÇ TË ZHVILLIMIT

Qeveria e Holandës, Austrisë dhe Japonisë, Komisioni Evropian dhe Global Environment Facility.

në vitin 2010, mbështetur nga investimet në infrastrukturën e fshatit në tre bashki bregdetare dhe 12 fshatra bregdetarë, që përfshijnë: ndërtimin e një sistemi për furnizimin me ujë për t'i shërbyer mëse 400 familjeve në Gjilek; rehabilitimin e sistemit të furnizimit me ujë për 167 familje në Vuno; sigurimin e furnizimit me ujë për 315 familje në Piqeras; ndërtimin e një rruge prej 1.3 km në Orikum për turistët ditore dhe banorët; rehabilitimin e 1.2 km rrugë që i shërben 132 familjeve dhe turistëve në Palasë; ndërtimin e trotuareve prej guri për këmbësorë në mënyrë që të sigurohet aksesimi në kalanë e Borshit për vizitorët dhe pelegrinazhet.

- Po zbatohet faza e dytë e programit (CVCD-1). Ajo përfshin përmirësime të vogla në infrastrukturë si rrugë fshati dhe sheshe si edhe sisteme të furnizimit me ujë në 12 fshatra në bashkitë e Sarandës dhe Himarës. Një program për rehabilitimin e çatave dhe fasadave po zbatohet në fshatrat e zgjedhur.
- Punime të mëdha rehabilituese për Saranda Gateway Passenger Terminal po zbatohen për të përmirësuar kapacitetin e portit të pasagjerëve për të prituri anije të mëdha turistike dhe infrastruktura në sipërfaqe të portit. Ndërtimi i landfillit në Bajkaj dhe rehabilitimi i furnizimit me ujë dhe ujitje në Sarandë priten të fillohen në mars 2013.

# Projekti i menaxhimit të përmirësuar të burimeve natyrore në Shqipëri

## DATA KRYESORE:

Aprovuar: 3 prill 2012  
Efektshmëria: 31 maj 2012

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Qeveria suedeze përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar	2.70

**O**bjekti i këtij projekti është: (i) të sigurojë mbështetje të vazhdueshme për manaxhimin e burimeve natyrore duke u bazuar tek komuniteti, veçanërisht në tokat malore që janë shpesh pre e erozionit. Kjo do të bëhet përmes planifikimit dhe investimeve pjesëmarrëse dhe (ii) të përgatisë një Projekt për Shërbimin Mjedisor. Ky projekt do të:

- Mbështesë përgatitjet në vijim të planeve pjesëmarrëse në manaxhimin e pyjeve dhe kullotave si edhe plane për ujëmbledhës të vegjël, siç është mbështetur tashmë nga Projekti për Zhvillimin e Burimeve Natyrore (PZhbN) financiar nga Banka dhe qeveria suedeze.
- Mbështesë zbatimin e punimeve në pyje dhe kullota, sekuestrimin e karbonit dhe ujëmbledhësit e vegjël, siç tashmë mbështetet nga PZhbN.
- Mbështesë përgatitjen e Projektit të propozuar të Shërbimit Mjedisor dhe
- Pilotojë skema konkurruese grantesh për manaxhimin e ujëmbledhësve për të mbështetur masat e targetuara dhe fushat për masat agro-mjedisore si edhe qasje të bazuara tek komuniteti në agro-mjedis.

## REZULTATET E ARRITURA

- Projekti sapo ka filluar zbatimin dhe po vijon me aktivitetet fillestare.

## PARTNERËT KYÇ

Banka Botërore po vepron si administrator i fondeve të grantit të qeverisë suedeze. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave ka përgjegjësinë e përgjithshme për projektin dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave është përgjegjëse për zbatimin përmes ekipit të vet të manaxhimit të projektit.

# Projekti për uljen e rrezikut të katastrofave natyrore

## DATAT KRYESORE:

Data e nënshkrimit: 19 qershor 2008

Data e fillimit: 18 qershor 2009

Data e mbylljes: 28 shkurt 2013

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Kredi e IDA-s	6.16
Hua e IBRD	3.00
Qeveria e Shqipërisë	1.01
<b>Kostoja Totale e Projektit</b>	<b>10.17</b>

## DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILION USD\*:

	Totali	Disbursuar	Pa Disbursuar
Kredi e IDA-s	6.16	3.00	4.23
Hua e BNRZh-së	2.64	0.80	0.06

\* deri në mars 2013.

Shënim: Shumat e paguara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

**S**hqipëria është lehtësisht e prekshme nga një sërë rreziqe katastrofash natyrore si tërmetet, përmytjet dhe thatësitrat. Nga mungesa e sigurisë ndaj katastrofave, rreziqet mund të kenë efekte shkatërruese mbi popullsinë shqiptare, ekonominë e saj primare dhe perspektivën e saj për rritje. Shqipëria ka një nga nivelet më të larta të lëkundjeve sizmike në Evropë. Duke patur parasysh faktin që shumë prej ndërtesave në Shqipëri nuk janë sipas standardeve të ndërtimit, impakti i tërmeteve mbi mjedisin e ndërtimeve përbën një shqetësim kryesor. Parashikimi i motit është i vështirë për shkak të precipitimeve që variojnë gjerësisht nga java në javë dhe nga viti në vit. Përmytja mund të ndodhë edhe si rezultat i një lajmërimi vetëm pak kohë përpara se të ndodhë ose pa paralajmërim. Ekonomia shqiptare është sidomos sensitive sa i përket kushteve të motit, duke patur parasysh

rëndësinë e bujqësisë, hidrocentraleve, peshkimit dhe turizmit. Kapacitetet e vendit për të parashikuar motin janë minimale për shkak të nivelit të lartë të amortizimit të rrjetit kombëtar të monitorimit të motit dhe atij hidrik dhe për shkak të kapaciteteve të ulëta të shërbimit të telekomunikacionit për të mbledhur inputet që nevojiten për parashikimin ditor.

Objektivat e zhvillimit të Projektit janë të forcojë kapacitetet institucionale për të ulur çënueshmërinë e Shqipërisë ndaj katastrofave natyrore dhe atyre që shkaktohen prej njeriut. Projekti ka katër komponentë kryesorë: Menaxhimin dhe përgatitjen për Rrezikun nga Shkatërrimet, Forcimin e Shërbimit Hidrometeorologjik, Zhvillimin dhe Forcimin e Kodeve të Banesave dhe Sigurimin ndaj Rrezikut për Katastrofat nëpërmjet pjesëmarrjes në një facilitet rajonal për sigurimin ndaj rreziqeve.



### **PARTNERËT KYÇ**

Ekipi i Bankës po bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Brendshme, Institucionin për Energjinë, Ujrat dhe Mjedisin, Ministrinë e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacioneve dhe Ministrinë e Financave për komponentin e sigurimit ndaj rrezikut të katastrofave.

### **PARTNERËT KYÇ TË ZHVILLIMIT**

Departamenti i Mbrojtjes Civile Italiane është partneri kyç që ofron financim paralel për këtë projekt.

## **REZULTATET E ARRITURA**

- Duke qenë një nga aktorët e parë të interesuar në Projektin e Lehtësisë Rajonale për Sigurimin ndaj Katastrofave (LRrSK), Shqipëria është vendi i parë në Evropën Juglindore që ofron akses për sigurime të përballueshme për pronarët e banesave, fermerët dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kundrejt rrezikut të përmytjeve, tërmeteve dhe shkatërrimeve të tjera që lidhen me motin.
- Njësitë përgjegjëse të emergjencës janë pajisur me varka shpëtimi për t'iu përgjurr rasteve të përmytjeve.
- Udhëzimet për Adoptimin e Kodeve të Ndërtesave Evropiane dhe Eurocode 8 ne veçanti, që sigurojnë udhëzime mbi prezantimin e standardeve të ndërtimeve rezistente ndaj lëkundjeve sizmike u zhvilluan dhe publikuan ndërkohë që u organizua edhe trajnimi përkatës.
- U ngritën qendrat e manaxhimit të emergjencave dhe operacioneve hidrike me software për monitorimin dhe parashikimin e zjarreve dhe përmytjeve si edhe buletine ditore të motit për këto kërcënime po i jepen autoriteteve përgjegjëse për përgjigjen ndaj emergjencave.
- Zhvillimi i Studimit gjithëpërfshirës për Vlerësimin dhe Manaxhimin e Rrezikut të Përmytjeve u financua nga Global Facility për Reduktimin dhe Rimëkëmbjen nga Shkatërrimi. Ky studim siguron një plan për të ndjekur investimet për mbrojtjen ndaj përmytjeve në basenet e lumenjve Drin dhe Bunë dhe përbën një bazë për t'iu afruar financuesve të ardhshëm në mënyrë që të bëjnë të mundur zbatimin.

## Projekti për administrimin dhe menaxhimin e tokës

### DATAT KRYESORE:

Data e nënshkrimit: 22 shkurt 2007  
 Data e fillimit: 23 korrik 2007  
 Ristrukturuar: 21 janar 2011  
 Data e Mbylljes: 30 qershor 2014

### FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Kredi e IDA-s	15.40
Huatë e IBRD	20.22
Qeveria e Shqipërisë	0.64
Bashkitë e Shqipërisë	0.96
SIDA	2.44
PHRD	1.54
<b>Kostoja Totale e Projektit</b>	<b>41.20</b>

### DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILION \$ \*:

	Totali	Disbursuar	Pa Disbursuar
Kredi e IDA-s	15.00	19.96	9.71
Hua e BNRZH	9.90	5.55	10.49

\* deri në mars 2013. Shënim: Shumat e paguara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

**T**ë drejtat e sigurta të pronësisë, bashkë me një regjim transparent të manaxhimit të tokës janë thelbësore për krijimin e një tregu funksional toke dhe pronësie në çdo vend. Këto në këmbim krijojnë incentiva për bizneset lokale dhe ndërkombëtare, për ekonomitë familjare dhe individët që të investojnë në toka dhe pronësi. Regjistrimi i saktë dhe të drejtat e pronësisë përbëjnë kushte sine qua non për decentralizimin fiskal dhe autonominë bashkiake që rrjedh nga të ardhurat prej taksave të pronës. Ku project ka si qëllim të lidhë sistemin e reformave të tokës dhe pronës me planifikimin e përforcuar urban dhe investimet bashkiake. Sëbashku, këto masa kanë si qëllim të përmirësojnë pers-

pektivën për zhvillim lokal. Për më tepër, me përmbytjet më të fundit në Prefekturën e Shkodrës dhe të Lezhës, disa financime projektsh lokale janë rishpërndarë për të bërë të mundur rikonstruktimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës mbrojtëse ndaj përmbytjeve dhe sistemin e furnizimit me ujë.

Objektivat e Zhvillimit të Projektit: Objektivat e projektit janë të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e administrimit dhe menaxhimit të tokës përmes rritjes së sigurisë të pronësisë dhe përmirësimit të planifikimit urban. Gjithashtu, përmes rindërtimit të aseteve fizike dhe restaurimit të shërbimeve esenciale në zonat e prekura nga përmbytjet, në prefekturat e Shkodrës dhe Lezhës.







## REZULTATET E ARRITURA

- Nën komponentin A të projektit është përfunduar regjistrimi i mbi 85500 titujsh.
- Dixhitalizimi i regjistrimit të pronës në zyrat e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme (ZRPP), ndër masat e tjera, e ka reduktuar kohën e regjistrimit të pronës nga 47 në më pak se 10 ditë.
- Strategjia ndërsektoriale për përmirësimin e të drejtës së pronës është aprovuar dhe ka kaluar ligji mbi regjistrimin e pronës së patundshme.
- Sistemi i automatizuar i regjistrimit të pronës është operues në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Fier me një lidhje online me noterët në zyrën e Tiranës.
- Një vlerësim i pavarur i shërbimve IPRP tregon se kënaqësia e konsumatorit është përmirësuar nga “shumë dobët” në fillim të projektit në “mirë”. Një Ligj i ri i Planifikimit të Territorit (LPT) (Mbështetur nga komponenti B) u miratua në prill 2009 dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) u themelua në fund të vitit 2009. Me mbështetjen financiare dhe teknike të Bankës

### PARTNERËT KYÇ

Grupi i Bankës Botërore po punon ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe IPRO; Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit; Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit; Ministrinë e Brendshme; Ministrinë e Bujqësisë; Mbrojtja e Ushqimit dhe Konsumatorit në Shqipëri dhe Bordi i saj i ujitjes dhe me bashki të përzgjedhura.

### PARTNERËT KYÇ TË ZHVILLIMIT

SIDA, Japonia përmes PHRD, USAID, BE dhe Këshilli i Evropës.

Botërore, një Manual Teknik dhe Guidë për Qytetarët në LPT-në e re dhe legjislacionin dytësor janë prodhuar dhe shpërndarë gjerësisht për të rritur ndërgjegjësimin rreth rregulloreve dhe procedurave të reja të planifikimit.

- Planifikimi dhe zhvillimi i ardhshëm i tetë qyteteve dhe qytezave në Shqipëri do të drejtohet nga Planet Gjithëpërfshirëse Territoriale që përfunduan nën Projektin, në nëntor të vitit 2010 bazuar në konsultime të gjera me komunitetin.
- Investimet bashkiake (mbështetur nga komponenti C) u përmbyllën në katër qytete me financimin që iu dha mbi bazën e secilit kriter kryesor për performancën. Investimet ndihmuan në sigurimin e hapësirave të tregjeve me pakicë për bizneset e vogla që më parë operonin përmes strukturave të improvizuara nëpër trotualet e rrugëve kryesore të qytezës së Beratit; rrugë të shtruara për të përmirësuar mobilitetin dhe aksesin e këmbësorëve në qytetet e Shkodrës dhe Kamzës; si edhe fasada të restauruara dhe përmirësuara të ndërtesave dhe objekteve në qendër të qytetit të Elbasanit.
- Një sistem gjithëpërfshirës adresash është instaluar në 13 qytete, duke përmirësuar shërbimet bashkiake dhe mbledhjen e taksave.
- Një rrjet për mbledhjen e ujit nga stuhitë që mat mbi 1 km është instaluar në qytetin e Shkodrës për të mbrojtur 150000 banorë, si edhe një numër të madh shtëpish dhe biznesesh të qytetit nga shirat e dendur sezonal dhe përmbytjet. Për më tepër, nën të njëjtin komponent D, restaurimet pas përmbytjeve janë përmbyllur, si edhe punimet për mbrojtjen e Stacioneve të Pompimit të Ujit në Dobrac dhe Bahçallëk, që i shërben të gjithë qytetit të Shkodrës (150000 banorë).



# Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale

## DATAT KRYESORE:

Data e nënshkrimit: 31 korrik 2007

Data e fillimit: 25 tetor 2007

Data e mbylljes: 30 qershor 2013

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Kredi e IDA-s	20.00
Qeveria e Shqipërisë	5.00
OPEC	15.00
<b>Kostoja Totale e Projektit</b>	<b>40.00</b>

## DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILION \$ \*:

Totali	Disbursuar	Pa Disbursuar
Kredi e IDA-s	20.00	17.9

\* deri në mars 2013. Shënim: Shumat e paguara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

**A**fërsisht gjysma (57 përqind) e popullsisë shqiptare jeton në zona rurale dhe mbi një e treta (35 përqind) e popullsisë rurale është llogaritur (në kohën e përgatitjes së projektit) se jeton në varfëri. Një vështrim cilësor i varfërisë dhe shkaqeve të saj, vuri në dukje se pas punësimit dhe të ardhurave, shumë shqiptarë e konsideronin infrastrukturën e dobët rrugore si një nga arsyt kryesore për vështirësitë e tyre dhe një faktor përcaktues për standardet e tyre të ulëta të jetesës. 49 përqind e prodhuesve rural deklaruan, në atë kohë, se mungesa e transportit të përshtatshëm, fillimisht e rrugëve të mira, ishte problemi i tyre më i madh për market-ingun. Banorët dhe liderët rural ishin të ndërgjegjshëm për faktin se akses i dobët në rrugët kombëtare e bën të vështirë për fermerët të arrijnë tregjet, kontribuon në migrimet drejt zonave urbane dhe ndikon në ofrimin e dobët të shërbimeve themelore shëndetësore dhe arsimore. Qeveria shqiptare i ka njohur këto mangësi dhe i kërkoi Bankës Botërore asistencë

për të përgatitur një plan për të: (i) përmirësuar menaxhimin, financimin dhe gjendjen e rrugëve dytësore në Shqipëri; (ii) mbështetur prezantimin e një sektori privat për mirëmbajtjen e rrugëve në rrjetin e rrugëve dytësore dhe lokale; dhe (iii) vepruar si katalizator për donatorë të tjerë në këtë sektor duke luajtur rol kryesues në përgatitjen e programit por edhe në tërheqjen e institucioneve të tjera financuese për të kontribuar.

Objekti i Zhvillimit të Projektit është të përmirësojë aksesin në shërbime bazë dhe në tregjet ekonomike duke siguruar rrugë të kalueshme në çdo stinë të vitit, për popullsinë rezidente në zonat e thella. Projekti do t'i arrijë këto objektiva përmes: (i) përmirësimit të seksioneve primare të rrjetit të rrugëve dytësore (rajonale) përgjatë Shqipërisë; (ii) përmirësimit të seksioneve primare të rrjetit rrugor lokal; (iii) prezantimit të sektorit privat për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor dytësor dhe lokal; dhe (iv) forcimit të manaxhimit të rrjetit rrugor dytësor dhe lokal.

## REZULTATET E ARRITURA

- Punimet kanë mbaruar në të 11 seksionet rrugore brenda projektit, 5 prej tyre iu dorëzuan përfituesve dhe pjesa tjetër që pritet të përfundojë Periudhën e Detyrueshme të Defektit, gjithsej 110 km. Të 5 indikatorët monitorues janë arritur. Përgatitja e Projektit të Rrugëve Lokale dhe Dytësore, që përfshin hartimin e një programi më të gjerë, ka ngjallur interes të madh ndër donatorët e tjerë, duke lëvruar një total financimi të konfirmuar, të ofruar ose të rënë dakord që arrin në rreth 500 milion \$, nga të gjitha burimet. Kjo përllogaritet se do të jetë e mjaftueshme për të rikonstruktuar rreth

### PARTNERËT KYÇ

Grupi i Bankës Botërore po punon ngushtë me Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, me Ministrinë e Financave dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, që është trupi kryesor përgjegjës për zbatimin e projektit.

### PARTNERËT KYÇ TË ZHVILLIMIT

BE, BERZH, BEI, KFW, OPEC, dhe COEB

1600 km rrugë lokale dhe dytësore.

- Agjencia zbatuese- Fondi Shqiptar i Zhvillimit- ka ofruar trajnime për zyrtarët e autoriteteve lokale të komunave mbi rëndësinë e mirëmbajtjes, arritjes së standardit, prokurimi dhe manaxhimi i kontraktorëve privatë për të ndërmarrë aktivitetet e mirëmbajtjes.
- Pas vendimit të Këshillit të Ministrave, një pjesë e rrjetit rrugor rajonal që është përmirësuar nën këtë program pritet të transferojë formalisht përgjegjësitë e mirëmbajtjes dhe operimit të tyre nga këshillat rajonalë tek Autoriteti Shqiptar i Rrugëve (AShR), që do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe funksionimin e tij. Në 16 maj 2012 qeveria e Shqipërisë kërkoi një shtyrje të datës së mbylljes së projektit dhe një rialokim të kredisë së Shoqatës Shqiptare të Zhvillimit vijon në mënyrë që të përdorë disa prej fondeve të mbetura (rreth 1.4 milion \$) për përmirësimin dhe rehabilitimin e një seksioni shtesë rruge (duke rritur kështu kilometrat e rehabilituar nën këtë projekt.



# Komuniteti energjetik i Evropës Juglindore

## APL5 – Shqipëri – Projekti për sigurinë e digave

### DATAT KRYESORE:

Data e nënshkrimit: 30 qershor 2008

Data e fillimit: 16 dhjetor 2008

Data e mbylljes: 31 dhjetor 2016

### FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Kredi e IDA-s	35.30
Hua e BNRZH	21.60
KESH	8.70
Donatorë të tjerë (SECO)	7.40
Donatorë të tjerë (BERZh)	16.50
Donatorë të tjerë (KfW)	20.50
<b>Kostoja totale e Projektit</b>	<b>110.00</b>

### DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILION \$ \*:

	Totali	Disbursuar	Pa Disbursuar
Kredi e IDA-s	33.20	6.63	26.57
Hua e BNRZH	20.74	0.25	20.48

\* deri në mars 2013. Shënim: Shumat e paguara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

**D**iga e fundit e hidrocentralit në Shqipëri u ndërtua në mesin e viteve 80'. Këto facilitete infrastrukturore kryesore nuk janë monitoruar në mënyrën e duhur dhe janë mirëmbajtur dobët për mëse 15 vjet dhe tashmë rrezikohet infrastruktura e tyre. Duke ndjekur alarmin e dhënë nga Banka Botërore për këtë çështje, një "Pyetësor për sigurinë e digave të hidrocentraleve mbi kaskadat e Drinit dhe Matit" u përgatit, financuar nga Sekretariati Zvicëran i Punëve Ekonomike (SECO). Studimi u përfundua në fund të vitit 2006. Raporti identifikoi mungesa serioze dhe arriti në përfundimin se "gjendja aktuale e digave është e pasigurtë dhe se katastrofa mund të konsiderohet e mundshme nëse çështja lihet që të përkeqësohet më tej". Mbështetja për hidrocentralet e Shqipërisë do të përmirësonte gjithashtu

edhe fuqinë hidrike në tërësi të vendit si dhe do të bënte që të përfitonte i gjithë sistemi rajonal elektrik. Më e rëndësishmja për tregun rajonal të energjisë është kapaciteti i konsiderueshëm grumbullues i digave, i cili mund të promovojë efikasitetin ekonomik në tregun rajonal.

Objekti i zhvillimit të projektit është zhvillimi i një tregu rajonal funksional në Evropën Juglindore dhe integrimi i tij në tregun e brendshëm të energjisë të Bashkimit Evropian nëpërmjet zbatimit të investimeve prioritare që mbështet tregun energjetik dhe veprimet e sistemit të shpërndarjes në prodhimin e energjisë elektrike. Projekti do të kontribuojë në sigurimin e digave kryesore energjetike të Shqipërisë dhe do të përmirësojë efikasitetin e tyre operacionale si dhe do të shtojë stabilitetin e furnizimit me energji





## REZULTATET E ARRITURA

- Studimi i dizenjimit të punëve riparuese në Projektin e Sigurisë së Digave është finalizuar (i ndërmarrë nga Konsulentë dhe i financuar nga SECO Zviceran).
- Paneli i Ekspertëve për Sigurinë e Digave është zgjedhur dhe është aktiv që prej 2009.

për tregun rajonal të energjisë. Projekti do të asistojë Shqipërinë në maksimizimin e përfitimeve nga hidrocentralet ekzistues, duke përmirësuar praktikat operacionale dhe të faciliteteve ekzistuese dhe duke mundësuar pjesëmarrje më aktive në tregun rajonal të energjisë. Projekti gjithashtu do të promovojë investimet e sektorit privat në hidrocentrale duke mbledhur, organizuar dhe mundësuar më shumë të dhëna dhe studime të potencialeve hidroenergjetike të vendit.

### PARTNERËT KYÇ

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Shqipërisë dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) si dhe agjencia zbatuese e Projektit.

### PARTNERËT KYÇ TË ZHVILLIMIT

SECO Zicerane, BERZh dhe KfW.

- Një vlerësim i punimeve rehabilituese në kaskadën e Drinit dhe në hidrocentralet e saj në kuadër të përmbytjeve gjatë fillimit dhe fundit të vitit 2010 kanë shtruar nevojën urgjente për të shtrirë këto përpjekjeve dhe për të mundësuar investime shtesë për të rritur impaktin e projektit dhe për të arritur objektivat e zhvillimit.
- Financimi Shtesë është aprovuar dhe zbatimi i punimeve të mëdha rehabilituese dhe civile ka filluar.
- Studimi për Përmbytjet në Kaskadën e Hidrocentralit të Lumit të Drinit u prezantua dhe bazuar tek ky studim do të ndërmerret përgatitja e një studimi për realizueshmërinë, hartimi i dokumentave përkatëse për Sigurimin e Manaxhimit të Mbrojtjes nga Përmbytjet dhe Kapacitetet e reja të Shkarkimit.
- Bazuar tek ekspertiza e mësipërme do të ndërmerren: Forcimi i Sigurisë së Digave, Zbatimi i Metodologjisë së Studimit të Rrezikut dhe Përgatitja e Planit në rast emergjencash.

# Garancia e riskut të pjesshëm për privatizimin e operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë në Shqipëri

## DATAT KRYESORE:

Data e nënshkrimit: 5 maj 2009

Data e fillimit: 15 maj 2009

Data e mbylljes: 31 maj 2017

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Hua të IBRD	78.00
Kostoja Totale e Projektit	78.00

## DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILLION USD \*:

	Totali	Disbursuar	Pa Disbursuar
Hua të IBRD	78.00	0.00	78.00

\*deri në mars 2013. Shënim: Shumat e paguara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

**S**hqipëria është përballur me një krizë të rëndë energjie qysh prej verës së vitit 2000. Kjo krizë ishte fillimisht rezultat i kërkesës së tepruar që rezultonte prej përdorimit të paligjshëm të elektricitetit dhe faturave të papaguara. Në rrënjë të problemit të sektorit të elektricitetit në Shqipëri ka qenë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), së fundi i ndarë si një kompani e veçantë. Qeveria, duke njohur rëndësinë e përmirësimit të performancës së shpërndarjes së elektricitetit dhe paaftësisë së strukturës shtetërore për të bërë progres domethënës, vendosi ta privatizojë atë. Investitorët potencialë shprehën shqetësimet e tyre mbi risqet rregullore lidhur me privatizimin e OSSH; IFC i rekomandoi qeverisë që të kërkonte instrumentin e Garancisë së Pjesshme të Riskut të Bankës Botërore të ndihmonte në lehtësimin e transaksionit.

Objektivi i operimit të Garancisë së Pjesshme të Riskut është lehtësimi i privatizimit të OSSH-së dhe Furnizuesit me Pakicë në kontekstin e një kornize të re dhe të pates-tuar rregullore, që është vendosur në korrik të vitit 2008 vetëm pak muaj para privatizimit dhe në mungesë të një baze të dhënash rregullore me OSSH private dhe strukturën aktuale të tregut. Rezultatet: indikatorët e rezultateve afatmesme të projektit janë: (i) investime paraprake kapitali janë bërë nga investitori për blerjen e aksioneve nga qeveria dhe (ii) funksionimi i OSSH-së dhe FP-së janë në përputhje me detyrimet e parashikuara në licencën e tyre dhe me zbatimin e programeve të investimit aprovuar nga Entiteti Rregullator i Energjisë (ERE). Indikatorët kryesorë për rezultatet janë: (i) reduktimi në humbjet e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe (ii) përmirësimi i mbledhjes në përputhje me parametrat e vendosur në Kornizën Rregullore.





### PARTNERËT KYÇ

Ministria e Financës; Ministria e Ekonomisë, Tregisë dhe Energjitikës; Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (CEZ Shpërndarje), që është edhe agjencia zbatuese për projektin; Autoriteti Shiptar Rregullues i Energjitikës dhe KESH dhe OST.

### PARTNERËT KYÇ TË ZHVILLIMIT

IFC.

## REZULTATET E ARRITURA

- Situata e furnizimit me energji në Sistemin e Shpërndarjes dhe furnizimi me pakicë si edhe siguria e furnizimit u përmirësuan. Furnizimi neto në Shqipëri është rritur me 5% çdo vit gjatë 4 viteve të fundit dhe ka arritur një vlerë prej 7621 gigavat në vitin 2012; sasia e importit ishte 3000 GVH (200 milion euro) në vitin 2011 dhe 2012.
- Nivelet e humbjeve në shpërndarje dhe borxhet e këqija ishin në mënyrë të konsiderueshme më të këqija gjatë dy viteve të fundit, duke ndjekur përkeqësimin e situatës financiare për aktivitetin shpërndarës dhe për të gjithë sektorin energjetik.
- Tarifat me shumicë dhe pakicë u aprovuan për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, por CEZ Shpërndarje dhe ERE punuan nën një frymë tejet jo bashkëpunuese në përpjekjet e tyre për të arritur marrëveshje për të ardhurat e kërkuara të sektorit, bazuar tek Deklarata Rregullatore.
- ERE hoqi licencën e CEZ Shpërndarje dhe caktoi një administrator të ri.
- Të dyja palët- qeveria e Shqipërisë dhe CEZ- pretendojnë prishjen e Marrëveshjes së Blerjes së Përbashkët dhe Deklaratën Rregullatore, si rezultat Garancia u thirr nga CEZ Shpërndarje; të dyja palët pretendojnë në arbitrazh.
- Privatizimi i shpërndarjes nuk ka prodhuar rezultate sa i përket përmirësimeve në shërbimin e shpërndarjes; përpjekje të tjera nevojiten për të rikthyer realizueshmërinë financiare të sektorit, jo vetëm për të reduktuar presionet në buxhet por edhe për të rritur sigurinë e furnizimit dhe për të maksimizuar manaxhimin e të ardhurave, duke mundësuar që Banka të ndërhyjë për të ndihmuar sektorin.



# Liberalizimi i tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik

## DATAT KRYESORE:

Data e nënshkrimit: korrik 2011

Data e fillimit: shtator 2011

Data e mbylljes: prill 2013

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit

Nisma FIRST

Kostoja Totale e Projektit

Financimi

0.328

**0.328**

## DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILLION USD \*:

	Totali	Disbursuar	Pa Disbursuar
FIRST	327,700	202,000	

\* Deri në mars 2013. Shënim: Shumat e paguara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të shkëmbimit në kohën e disbursimit..

**O**bjektivi i këtij projekti: Projekti do të ndihmojë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në hartimin e politikave dhe proceseve që mundësojnë largimin nga përcaktimi i çmimit sipas tarifave të menaxhuara në mënyrë të centralizuar drejt një çmimi plotësisht të liberalizuar me bazë rrisë të produkteve të tregut të sigurimeve të detyruara motorike. Kjo lëvizje do të mundësojë praktika më homogjene dhe të rrisë efikasitetin administrativ dhe rregullator, si dhe të rrisë përgjegjësinë e konsumatorëve përmes paraqitjes së një lidhjeje dinamike ndërmjet kostos së primit të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe sjelljes në rrugë. Projekti do të ndihmojë që të përafrojë kuadrin ligjor vendas për tregun e sigurimeve me direktivat e Bashkimit Europian në përputhje kjo me angazhimet e Shqipërisë në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit me Bashkimin Europian.

## PARTNERËT KYÇ

Autoriteti Shqiptar i Mbikëqyrjes Financiare.

## REZULTATET E ARRITURA

- Vlerësimi i situatës aktuale të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe një rishikim të arkitekturës së sistemit të qendrës së informacionit për sigurimin e detyrueshëm.
- Plani strategjik i veprimit, i cili vendos parimet për liberalizimin e tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik.
- Diskutimin e planit të punës në një seminar me stafin teknik të AMF-së
- Raporti, i cili bën rishikimin dhe ofron rekomandime për ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor ekzistues për të mundësuar liberalizimin e sigurimit të detyrueshëm motorik.
- Një model actuarial dhe një përshkrim i detajuar i metodologjisë për llogaritjen e policave të sigurimit, rezervave dhe tarifave
- Udhëzues për strukturën organizative për kompanitë e sigurimeve
- Bazën e të dhënave për kërkesat dhe udhëzuesit se si të përshtatesh në një treg të liberalizuar.
- Raportin përfundimtar përmbledhës dhe planin e veprimit më afate kohore të përcaktuara
- Raportin mbi rezervat
- Seminar Actuarial në Tiranë
- Vizitë studimore në Turqi

**PROJEKTET IFC**

# Projekti i eficiencës së energjisë për banesat

## DATAT KRYESORE:

Aprovuar: janar 2009  
Mbyllja: dhjetor 2015

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Hua e IFC-së	0.76
Kosto totale e projektit	0.76

**K**y projekt do të sigurojë mbështetje për institucionet financiare për të zgjeruar huatë e vogla dhe për të siguruar efikasitet energjetik, ulje të konsumit energjetik dhe përmirësime në komoditet. Për më tepër, objektivi është të punohet ngushtë me Shërbimet e Investimeve për të rritur impaktin e projektit. Ai përbëhet prej tri komponentësh: (i) Ndërgjegjësimi Publik: disa aktivitete do të ndërmerren në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi publik mbi efikasitetin energjetik dhe kursimet në energji; (ii) Shërbime Këshilluese për Institucione Partnere Financiare. Ky komponent është për të mbështetur institucionet partnere financiare të ndërtojnë një produkt të ri të efikasitetit energjetik dhe për ta drejtuar tek tregu i përshtatshëm i targetuar si edhe (iii) Kornizë rregullatore për të mbështetur Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) në rishikimin e draft ligjit për efikasitetin energjetik dhe në zhvillimin e akteve nënligjore përkatëse.

## PARTNERËT KYÇ

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shoqata Shqiptare e Bankave, Institucionet Financiare: Credins Bank sh.a, Societe General Albania, Fondi BESA, NOA

## DONATORË

Fonde Austriake (TATF).

## REZULTATET E ARRITURA

- Projekti ngriti një website për eficiencën e energjisë, i pari i llojit të tij në Shqipëri dhe në partneritet me agjenci kyçe energjetike, organizoi gjithashtu gjashtë seminare për të rritur njohuritë publike mbi çështjet teknike dhe përfitimet ekonomike të investimeve në eficiencën e energjisë.
- Partneritet me 4 institucione financiare, prezantimi i huave të vogla që targeton përmirësimet në eficiencën e energjisë. Në dhjetor 2012 projekti kishte disbursuar 2,000 hua për eficiencën e energjisë për 7.5 milion \$, që çoi në mesatarisht 11,000 megavat kursime në energji dhe rreth 14,000 (ton për vit) gazi serë u shmang.
- Projekti mbështeti Agjencinë Energjetike në rishikimin e draft ligjit për Eficiencën e Energjisë dhe zhvillimin e akteve nënligjore përkatëse që promovojnë zgjidhje duke financuar iniciativa që lidhen me përdorimin eficient të energjisë dhe kursimet në energji. Paketa ligjore e 6 akteve nënligjore është dorëzuar dhe po pret aprovim.

# Hidrocentralet e vogla në Shqipëri dhe energjia e rinovueshme

## DATAT KRYESORE:

Aprovuar: janar 2009

Mbyllja: qershor 2017

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Hua e IFC-së	1.7
Kostoja totale e projektit	1.7

**K**y projekt pesë vjeçar është pjesë e një Programi më të gjerë rajonal në Ballkanin Perëndimor #550626. Programi do të impelemntohet në tri vende të Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Maqedoni- që ofron potencialet më të mëdha të impaktit dhe ku ka patur progres të mjaftueshëm nga qeveritë federale në zbatimin e kornizave rregullatore.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit në Shqipëri është krijimi i një kornize gjithëpërfshirëse për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve për hidrocentralet e vogla (SHPP). Ky qëllim do të arrihet përmes zbatimit të tre objektivave individuale:

1. Përmirësimi i kornizës ekzistuese rregullatore për të mundësuar që sponsorët e SHPP të zhvillojnë dhe ndërtojnë SHPP të realizueshme
2. Punojë me sponsorët e SHPP-ve për të përmirësuar dizanjot e tyre dhe planet e biznesit
3. Punojë me institucionet e përzgjedhura financiare në Shqipëri për të përmirësuar kapacitetet e brendshme si edhe dijet mbi SHPP-të dhe financimin e projekteve.

## REZULTATET E ARRITURA

- Krijimi i një kornize gjithëpërfshirëse për zhvillimin dhe zbatimin e projektit të energjisë së rinovueshme me një fokus tek SHPP-të në Shqipëri.
- Adresimi i barrierave të tregut për të mundësuar investime tek SHPP-të duke punuar mbi legjislacionin me zhvilluesit dhe përmes institucioneve financiare.
- Impaktet e pritshme janë: lehtësimi i të paktën 90 milion \$ investimesh tek ndërtimi i SHPP-ve; mbështetja e ndërtimit të 30 SHPP-ve me një kapacitet total prej 60 megavatësh si edhe duke shmangur në mënyrë të drejtpërdrejtë 0.15 metrik ton emetimi të gazit karbonik çdo vit.

### PARTNERËT KYÇ

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE); Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë (UCIALAlbania); Enso Hidro Energju sh.p.k; Credins Bank sh.a

### DONATORË

Ministria Austriake e Financave.





# Shqipëria: Programi i Evropës Juglindore për transparencën dhe thjeshtëzimin e taksave

## DATAT KRYESORE:

Aprovuar: 6 dhjetor 2012

Mbyllja: 30 qershor 2015

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
SECO	2.88
Kosto totale e projektit (rajonal)	3

**Q**ëllimi i përgjithshëm i projektit është të përmirësojë përputhshmërinë e taksave duke rritur transparencën dhe thjeshtëzimin e procedurave të administrimit të taksave. Programi i Evropës Juglindore për Transparencën dhe Thjeshtëzimin e Taksave do të punojë në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbi për të arritur dy objektiva:

1. Thjeshtëzimin e procedurave për administrimin e taksave për të reduktuar kostot e pajtueshmërisë së taksave, veçanërisht për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme.
2. Përmirësimin e kornizës ligjore dhe efikasitetit të administratës të procedurave të taksimit ndërkombëtar, me një fokus tek Transferimi i çmimit (dhe traktatet e Taksimit të Dyfishtë).

## REZULTATET E ARRITURA

- Sondazhi mbi kostot e pajtueshmërisë së taksave është në proces e sipër (1000 biznese do të intervistohen) për të identifikuar dhe adresuar çështjet që lidhen me të.
- Trajnimi i stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave mbi transferimin e çmimeve.

### PARTNERËT KYÇ

Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave.

# Shqipëria: Zgjidhja e borxhit

## DATAT KRYESORE:

Aprovuar: korrik 2012

Mbyllja: dhjetor 2015

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit

Donatorë të tjerë (nëse ka)

Kosto totale e projektit

Financimi

TBD

0.75

**R**ezultati i pritur i zbatimit të Programit të Ballkanit Perëndimor në Shqipëri është që sistemi i zgjidhjes së borxhit të bëhet më efikas duke përmirësuar kornizën dhe praktikën e paaftësisë paguese që do të çojë në një rrugë të përforcuar zgjidhjen e huave të këqija, rritjen e rikthimit tek kreditorët si edhe mbrojtjen ekonomike të kompanive të besueshme.

Rezultatet specifike për secilin objektiv dhe aktivitetet janë renditur më poshtë:

1. Reforma rregullatore dhe ligjore: vendosja dhe ofrimi i kornizës ligjore dhe rregullatore efektive dhe efikase në fushën e falimentimit.
2. Reforma procedurale, përforcimi dhe zbatimi, reforma institucionale.
3. Aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit.

## PARTNERËT KYÇ

Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Shqiptare e Mbikqyrjes së Falimentimit

## REZULTATET E ARRITURA

Projekti është në fazën e zbatimit. Deri më tani programi është fokusuar tek:

- Aktivitete për rishikimin e legjislacionit dhe dhënia e asistencës për të përmirësuar kornizën ligjore për zgjidhjen e borxhit.
- Sigurimi i trajnimit për stafin e Agjencisë Shqiptare të Administrimit të Falimentimit për të mundësuar transferimin e dijeve, aftësive dhe udhëheqjes nga një ekspert i falimentimit nga Mbretëria e Bashkuar.

# Shqipëria: Projekti i IFC-së në Ballkanin Perëndimor për logjistikën e tregtisë

## DATAT KRYESORE:

Aprovuar: 1 shtator 2011

Mbyllja: 30 qershor 2014

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Komisioni Evropian	2.00
Kostoja totale e projektit (Rajonale)	2.00
Kostoja totale e projektit Shqipëria	0.35

**P**rojekti i Ballkanit Perëndimor për Logjistikën e Tregut operon në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Mal i Zi dhe Serbi për të arritur dy objektiva kryesore:

- Reduktimi i numrit të dokumentave dhe ditëve që nevojiten për importimin dhe eksportimin e të mirave
- Procedura të efektshme për lëvizjen e kargove me rrugë, ajër dhe lumenj

Ky projekt ka për qëllim të reduktojë pengesat rregullatore dhe administrative ndaj tregtisë ndër-kufitare në rajon përmes procedurave më të efektshme të importeve, eksporteve dhe tranzitit; bashkëpunim më i afërt dhe i harmonizuar ndërmjet agjencive brenda vendit por edhe ndërmjet vendeve si edhe përdorim më të madh të sistemeve elektronike për shkëmbimin e të dhënave, kontrolle të bazuara tek rreziku si edhe pagesa që lidhen me logjistikën e tregtisë. Objektivi i këtij projekti është të përmirësojë konkurrueshmërinë e sektorit privat në rajon përmes aksesit më efikas ndaj tregjeve rajonale dhe globale. Aktivitetet e zbatuara nga projekti do të rezultojnë në 10 milion \$ kursime në sektorin privat.



## PARTNERËT KYÇ

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës si edhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

## REZULTATET E ARRITURA

- Disa takime me agjencitë doganore dhe jo doganore si edhe përfaqësues të sektorit privat për të identifikuar pengesat në logjistikën e tregtisë dhe për të diskutuar zgjidhje të mundshme.
- Aktualisht po punohet për finalizimin e Marrëveshjes së Lehtësimit të Tregut Tranzit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës për të mirat që hyjnë në portin e Durrësit me destinacion Kosovën përmes Pikës kufitare Vernicë-Morinë.
- Po bashkëpunohet me Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD) për të zhvilluar një modul software për aksesin në kohë reale për doganat, për sa i përket pagesave të bëra nga tregtarët në banka lokale në mënyrë që të reduktohet periodha e transaksionit.





## Shqipëria: Enso Hidro Energji

### DATA KRYESORE:

Aprovuar: shkurt 2012

### FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
Kapitali i IFC	8.4
Kostoja totale e projektit	105

**I**FC-ja investoi 6 milion \$ për 20% të aksioneve në Enso Hidro Energji për të ndihmuar në ndërtimin e një serie projektesh hidrike në Shqipëri. Ky investim do të rrisë gjenerimin e elektricitetit të vendit dhe reduktimin e importeve të energjisë. Zhvilluesi austriak Enso Hidro themeloi Enso Hidro Energji për të zhvilluar hidrocentrale të vogla dhe të mesme në Shqipëri. Gjatë periudhës 2012-2015, kompania ka për qëllim të investojë rreth 75 milion euro në vend për të ndërtuar centrale të reja që do të kenë kapacitetin për të prodhuar rreth 50 megavat hidroenergji. Ky investim mbështet strategjinë tonë për Shqipërinë për të stimuluar investimin tek burimet e energjisë së rinovueshme si hidroenergji.

### PARTNERËT KYÇ

Enso Hydro Energji.

## REZULTATET E ARRITURA

- Projekti ndihmon në reduktimin e pengesave infrastrukturore për të stimuluar rritjen ekonomike të Shqipërisë.
- Projekti mbështet zhvillimin e një sektori energjetik të qendrushëm që varet më pak tek importet e kushtueshme dhe për rrjedhojë përmirëson konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare.
- Suksesi i projektit do të dërgojë gjithashtu një sinjal të fortë mbështetjeje për reformimin e vazhdueshëm të sektorit energjetik që është kritik për suksesin afatgjatë të sektorit energjetik.
- Projekti mbështet zhvillimin e projekteve të gjenerimit të energjisë bazuar tek energjia e rinovueshme dhe ndihmon në mbështetjen e ruajtjen e ujit në digat hidroenergjetike duke e rritur prodhueshmërinë në hidrocentrale të llojit që vendosen mbi lumenj.

# Shqipëria: Bankers Petroleum

## DATA KRYESORE:

Aprovuar: shtator 2009

## FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesit	Financimi
IFC	55
BERZH	55
<b>Kostoja totale e projektit</b>	<b>370</b>

**I**FC-ja dhe BERZH bashkëfinancuan projektin dhe kanë dhënë 10.4 milion \$ në kapital dhe 30 milion \$ në hua për projektin, si edhe një hua prej afërsisht 5 milion \$, secila në formën e një huaje me qëllim special mjedisor.

Projekti përfshin ri-zhvillimin e mëtejshëm të fushës së naftës Patos Marinzë në jug të Shqipërisë. Kostoja e përlogaritur e projektit është 370 milion \$ dhe përfshin: (i) zgjerimin dhe riaktivizimin e puseve ekzistuese në fushë dhe (ii) shpimi i puseve të reja horizontale dhe vertikale dhe mbajtja e testimit paralel dhe aplikimi i strategjive shtesë, duke përfshirë përmbytjet dhe stimulimin e avujve ciklik, për të rritur më tej rimëkëmbjen e naftës. Koha e përlogaritur e projektit është 5 vite, në varësi të çmimeve të naftës.

## PARTNERËT KYÇ

Bankers Petroleum, BERZH

## REZULTATET E ARRITURA

- Investimi ndihmoi në promovimin dhe integrimin e praktikave më të pastra dhe më të qendrueshme në prodhimin e naftës në Shqipëri.
- Projekti ndihmoi në përshtetimin e prodhimit të brendshëm të naftës dhe shifrat e rimëkëmbjes nga burimet ekzistuese në vend.
- Projekti ndihmoi për të çuar më tej zhvillimin e aftësive lokale dhe transferimin e dijeve dhe teknologjisë për nxjerrjen e naftës së rëndë në Shqipëri.
- Projekti ka kontribuar në rritjen e të ardhurave të qeverisë.
- Shitjet e naftës mesatarisht arrijnë 14000 fuçi naftë në ditë duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2012, që është një rritje prej 17% krahasuar me vitin e mëparshëm.
- Prodhimi i forte është përkthyer në pagesa besnike ndaj qeverisë shqiptare. Për shembull, në vitin 2011, 67 milion \$ iu paguan qeverisë shqiptare dhe entiteteve që lidhen me të krahasuar me 23 milion \$ që pritej kur u krye transaksioni.
- Bankierët hartuan dhe përfunduan një projekt rehabilitimi në vitin 2011 për të pastruar ndotjen historike.
- Plane të mëtejshme përfshijnë rehabilitimin e zonave të ndrotura në zonën e projektit, zbatimin e planeve për manaxhimin e mbetjeve të ngurta si edhe pastrimin mjedisor të një prej gropave historike ekologjike.

# PROJEKTET MIGA



# Shqipëria: Energji Ashta Shpk (ASHTA)

ID e projektit: 7869  
Viti fiskal: 2012  
Statusi: aktiv  
Mbjtësi i garancisë: EVN, AG  
Vendi investees: Austria  
Vendi pritës: Shqipëria  
Kategoria mjedisore: A  
Sektori: Energjetika

Data e hapjes: 7 nëntor 2011  
Data e bordit të projektit: 31 janar 2012  
Ekspozimi bruto: 159.4 milion \$  
Lloji i projektit: Non-SIP  
Fusha strategjike prioritare: Projekt Kompleks  
ESRS: Përmbledhja mjedisore dhe sociale për Energji Ashta Shpk në Shqipëri

Në 1 shkurt 2012, Agjencia Multilaterale për Garanti-min e Investimeve (MIGA) lëshoi garanci që arrinin një total prej 121.4 milion euro (159.4 milion \$) ndaj EVN Ag e Austrisë për investimet e saj tek Energji Ashta shpk në Shqipëri. Mbulimi i MIGA-s vlen deri në 20 vjet për investimet e saj kapitale dhe deri në 10 vjet për huatë e saj të garancisë. Mbulimi sigurohet kundrejt rrezikut për kufizimin e transferimit, shpronësimin, luftë dhe shqetësime civile si edhe shkeljen e kontratës.

Projekti përfshin rikonstruksionin e një hidrocentrali prej 52.9 megavat në baza ndërto, zotëro, opero dhe transfero nën një marrëveshje koncesioni prej 35 vitesh që fillimisht hyri në fuqi ndërmjet VERBUND AG dhe Ministrisë së Ekonomisë të Shqipërisë. Në vitin 2010, dy sponsorët e projektit, EVN AG dhe VERBUND AG, negociuan një marrëveshje aksionerësh për të zhvilluar dhe operuar një projekt sëbashku.

Ky projekt është hidrocentrali i tretë mbi lumin Drin por

i pari që ndërtohet këto 30 vitet e fundit. Vendodhja e tij është në qarkun e Shkodrës në very-perëndim të Shqipërisë. Zhvilluesit kanë nënshkruar marrëveshje me furnizuesin publik të shitjeve me shumicë në Shqipëri, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare Sh.A (KESH). Projekti pritet të ketë impakt të lartë zhvillues duke siguruar energji të pastër dhe të rinovueshme ndërkohë që ndimon në lehtësimin e ndërprerjes së energjisë elektrike afat mesëm dhe afatgjatë. Projekti do të reduktojë gjithashtu importet dhe reduktimet e elektricitetit. Projekti përshtatet me Strategjinë e Bankës Botërore për Shqipërinë. Një prej tre objektivave strategjike të kësaj strategjie është përsheptimi i rimëkëmbjes ekonomike të Shqipërisë përmes shërbimeve të përmirësuar dhe financiarisht të qendrueshme infrastrukturore si rrugët, energjetika dhe ujitja. Në sektorin energjetik, strategjia fokusohet tek konsolidimi i reformave aktuale dhe përfundimi i projekteve të nisura, duke promovuar ndërkohë mekanizma të reja financimi privat.

# Shqipëria: Mbulimi i detyrueshëm i rezervave nga Banka Qendrore të Grupit Procredit

ID e projektit: 9186  
 Viti fiskal: 2011  
 Statusi: Aktiv  
 Mbajtësi i garancisë: Procredit  
 Vendi investues: Gjermania  
 Vendi pritës: Shqipëria  
 Kategoria mjedisore: FI

Sektori: Bankar  
 Data e hapjes: 5 tetor 2011  
 Data e Bordit të projektit: 31 janar 2012  
 Ekspozimi bruto: 25.0 milion \$  
 Lloji i projektit: Non-SIP  
 Fusha strategjike prioritare: Projekt kompleks

**N**ë 22 dhjetor 2010, MIGA dha një garanci prej 25 milion \$ për ProCredit Holding (PCH) duke mbuluar investimin e tij në filialin në Shqipëri. Mbulimi vlen për një periudhë deri në 10 vite kundrejt rrezikut të shpronësimit për fondet për rezervat e detyrueshme të mbajtura nga filiali në bankën qendrore të juridiksionit të saj.

Ky projekt është pjesë e një kontrate madhore që MIGA ka nënshkruar. PCH i ka zyrat qendrore në Gjermani dhe është kompania mëmë e 21 bankave (Grupi ProCredit). Grupi ProCredit është sigurues i financave për rreth 750000 sipërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme në Amerikën Latine, Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Afrikë. Nëpër gjithë botën bankave u kërkohet të ruajnë rezerva të detyrueshme me bankën qendrore të juridiksionit të tyre përkatës. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të grupit ProCredit përlogaritet sipas Aktit Bankar Gjerman. Sipas këtij akti, në një nivel të konsoliduar, rezervat e depozituara tek bankat e ndryshme qendrore mund të tërheqin një rrezik që arrin 100 madje edhe 150% në varësi të vendit. Peshimi i rrezikut përcakton shumën e kapitalit të kërkuar për të ruajtur një raport specifik në përputhje me Aktin Bankar Gjerman.

Garancia e lëshuar nga MIGA do të ndihmojë PCH-në të marrë lehtësim kapitali nga kërkesat e CAR. Duke marrë fi-

nancimin e MIGAs kundër rrezikut të shpronësimit të fondeve, peshimi i riksut për rezervat e detyrueshme mbajtur tek Banka Qendrore mund të reduktohet. Një peshim risku më i ulët do të lejojë PCH-në të lirojë kapitalin që për momentin është i lidhur për qëllimet e mirëmbajtjes së CAR-it, duke lejuar kështu që këto fonde të injektohen në bankat filiale. Në këmbim kjo do të lejojë tregun në zhvillim të bankave filiale të PCH-së nëpër të gjithë rrjetin, të rrisin aktivitetet huadhënëse.

Mbështetja e MIGAs do ta ndihmojë PCH-në të optimizojë manaxhimin e saj të kapitalit nëpër të 21 bankat, duke e lejuar kështu PCH-në të drejtojë kapitalin tek filialet me nevojën më të madhe. Këto banka do të mund të ofrojnë shërbime shtesë financiare ndaj sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në një kohë sfidash makroekonomike. Mbështetja e bizneseve të vogla produktive do të ndihmojë në stimulimin e rritjes, gjenerimin e punësimit dhe reduktimin e varfërisë.

Mbështetja e MIGAs për këtë projekt është në përputhje me strategjinë e Grupit të Bankës Botërore për mikrofinancimin, që përfshin përmirësimin e furnizimit të mikrofinancës; rritja e kapaciteteve të depozitimit duke asistuar institucionet e mikrofinancës në mobilizimin e kursimeve; promovimi i ndërtimit të kapaciteteve; krijimi dhe formësimi i tregjeve dhe nxitja e inovacionit.



ProCredit Bank



ProCredit Bank



TELEVIZIJA LEVIZE



## Shqipëria: Giorgi Alfo SH.P.K.

ID e projektit: 1163

Viti fiskal: 2000

Statusi: aktiv

Mbajtësi i garancisë: Ge/Por.Tur.s.a.s.

Vendi investitor: Italia

Vendi pritës: Shqipëria

Sektori: turizmi

Totali bruto: 1.6 milion \$

Lloji i projektit: Non-SIP

Në projektin e saj të parë në Shqipëri, MIGA dha një garanci prej 1.6 milion \$ për Ge.Por..Tur.s.a.s. për investimet e saj kapitale në Giorgi Alfo Sh.p.k, Ge.Pot.Tur do të hartojë, ndërtojë dhe operojë një marinë turistike- duke përfshirë një kabinë, restorant, supermarket, klub jahti dhe spirancë për varkat- në jug të bregdetit shqiptar. Garantuesi sigurohet kundër rreziqeve të konfiskimit.

Projekti është një kontribut ndaj përpjekjeve të udhëhequra nga Banka Botërore dhe Komisioni Evropian në Ballkan pas luftës së Kosovës, që shkaktoi ndërprerje të mëdha në tregti,

infrastrukturë dhe turizëm në vendet fqinje.

Qeveria shqiptare pret që turizmi të kthehet në një burim të madh të ardhurash. Marina e parë në bregdetin shqiptar do të jetë një hap modest drejt arritjes së këtij qëllimi- pritet që do të ndihmojë të plotësohen kërkesat në rritje nga vendet evropiane për portet turistike në jug të detit Adriatik. Pritet gjithashtu që të krijohen vende pune dhe trajnime të përhershme për rreth 50 qytetarë vendas. Në hartimin e tij, porti është sensitiv ndaj mjedisit, pasi minimizon shqetësimin e peizazhit për të ruajtur bukurinë e vijës bregdetare.





